

ANKESË

DREJTUAR: **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Prishtinë**

NGA: **GRUPI I OPERATOREVE EKONOMIK – GOE (ANKUES): MEB L.L.C. dhe CPS Phoenix Group L.L.C.**, me adresë të regjistruar: Rruga „Edit Durham“ Nr. 213/B, Prizren.

KUNDËR: **AUTORITETI KONTRAKTUES (AK): Kuvendi Komunal Mitrovicë (Komuna e Mitrovicës Jugore)**, Titulli: *Shërbimet e pastrimit të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve*, me numër të prokurimit: **642-26-4703-2-1-1**.

Data: 14.09.2026



Mbi bazën e **nenit 105, nenit 108/A dhe nenit 109** të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, Grupi i Operatorëve Ekonomikë **MEB L.L.C. dhe CPS Phoenix Group L.L.C.**, në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe palës me interes juridik në procedurën e prokurimit me titull: *Shërbimet e pastrimit të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve*, me numër të prokurimit: **642-26-4703-2-1-1**. paraqet këtë:

ANKESË

Kundër Vendimeve të Autoritetit Kontraktues (AK) – **Kuvendi Komunal Mitrovicë (Komuna e Mitrovicës Jugore)**:
Kjo ankesë parashtrohet kundër:

1. Vendimit të Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit, të datës **25.08.2026**; dhe
2. Vendimit të Autoritetit Kontraktues, të datës **04.09.2026**, me të cilin është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga **GOE MEB L.L.C. & CPS Phoenix Group L.L.C.** dhe është lënë në fuqi anulimi i aktivitetit të prokurimit.

Ankuesi, në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës, palës së interesuar dhe palës së dëmtuar drejtpërdrejt nga vendimmarrja e kundërligjshme e Autoritetit Kontraktues, në mbështetje të dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, paraqet këtë ankesë për shkak të:

1. Shkeljes dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale;
2. Shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe të legjislacionit dytësor për prokurimin publik;
3. Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;

4. **Mosshqyrtimit të provave dhe dokumentacionit material të dorëzuar nga Ankuesi;**
5. **Mungesës së arsytimit të plotë, konkret dhe të verifikueshëm të vendimeve të kundërshtuara;**
6. **Shkeljes së parimeve të trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, konkurrencës së drejtë dhe përdorimit ekonomik të fondeve publike;**
7. **Zbatimit të një standardi të dyfishtë dhe arbitrar gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve; dhe**
8. **Anulimit të kundërligjshëm të aktivitetit të prokurimit, ndonëse në këtë procedurë ekziston një tender i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.**

A r s y e t i m

Vendimet e kundërshtuara janë juridikisht të paqëndrueshme, faktikisht të pabazuara dhe të nxjerra në kundërshtim me parimet themelore dhe dispozitat detyruese të prokurimit publik.

Autoriteti Kontraktues, në vend që të kryente një ekzaminim dhe rivlerësim objektiv, profesional dhe përmbytësor të ofertës së Ankuesit, ka përdorur interpretime skajshmërisht formaliste, selektive dhe joproporcionale, duke i shndërruar çështjet që nuk ndikojnë në substancën e tenderit në arsye eliminuese. Në të njëjtën kohë, AK-ja nuk ka bërë ballafaqimin e pretendimeve të Ankuesit me provat konkrete të dorëzuara, nuk ka identifikuar parametrin teknik që pretendohet se nuk është përmbushur dhe nuk ka shpjeguar se në çfarë mënyre vlefshmëria e tenderit prej 365 ditësh cenon kërkesën prej 90 ditësh, interesin publik apo pozitën konkurruese të operatorëve të tjerë.

Në vendimin e datës 04.09.2026, AK-ja kryesisht ka përsëritur përfundimet e veta paraprake, pa ofruar një analizë të individualizuar juridike dhe teknike për secilën provë dhe secilin pretendim ankimor. Përsëritja e formulimit të kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe deklarimi se ajo “nuk është përmbushur” nuk përbëjnë arsyetim të ligjshëm të një vendimi administrativ.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar të përcaktojë qartë:

- cilin parametër konkret teknik nuk e përmbush pajisja e deklaruar nga Ankuesi;
- mbi cilën provë është mbështetur konstatimi për papërgjegjshmërinë e tenderit;
- cilat dokumente teknike janë shqyrtuar dhe përse janë refuzuar;
- në çfarë mënyre mospërputhja e pretenduar është materiale dhe eliminuese;
- përse vlefshmëria më e gjatë se minimumi i kërkuar konsiderohet e papranueshme;
- dhe cili interes konkret i AK-së, i operatorëve të tjerë apo i konkurrencës është cenuar.

Asnjëra nga këto çështje nuk është trajtuar në mënyrë të plotë, bindëse dhe të verifikueshme.

Përkundrazi, vendimi mbështetet mbi supozime, përfundime të përgjithshme dhe dallime thjesht terminologjike, pa ekspertizë teknike dhe pa administrim të drejtë të provave. Një vendim eliminues nuk mund të ndërtohet mbi hamendësime dhe as mbi interpretimin më kufizues të mundshëm ndaj një operatori ekonomik.

Veçanërisht arbitrar është konstatimi se deklarimi i vlefshmërisë prej **365 ditësh** nuk e përmbush kërkesën prej **90**

ditësh. AK-ja nuk ka bërë dallimin elementar ndërmjet një afati minimal dhe një afati maksimal apo fiks. Oferta e Ankuesit nuk ka qenë e vlefshme më pak se periudha e kërkuar; **përkundrazi, ajo ka mbetur juridikisht detyruese për një periudhë dukshëm më të gjatë, duke i ofruar AK-së siguri shtesë dhe jo më të vogël.**

Gjithashtu, AK-ja nuk mund ta shpallë pajisjen të papërshtatshme vetëm për shkak të **emërtimeve të saj formal, pa shqyrtuar karakteristikat, kapacitetin, lartësinë e arritshme, funksionalitetin dhe dokumentacionin teknik të dorëzuar.** Nëse AK-ja ka konsideruar se ekziston paqartësi teknike, ajo është dashur ta shqyrtojë dokumentacionin ekzistues dhe, kur ka qenë e nevojshme, të kërkojë sqarim që nuk ndryshon përmbajtjen materiale të tenderit.

Anulimi i aktivitetit është mbështetur në **nenin 43.5(b)** të Rregullores për Prokurimin Publik, me arsyetimin se asnjëri nga tenderët e pranuar nuk është i përgjegjshëm. Mirëpo, kjo dispozitë mund të zbatohet vetëm pasi papërgjegjshmëria e të gjitha ofertave të jetë konstatuar në mënyrë të ligjshme, objektive dhe të plotë.

Në rastin konkret, anulimi nuk është rezultat i mungesës reale të një tenderi të përgjegjshëm, por pasojë e drejtpërdrejtë e eliminimit të gabuar të ofertës së Ankuesit. AK-ja nuk mund ta përdorë anulimin si instrument për të ruajtur pasojat e një vlerësimi të kundërligjshëm.

Oferta e Ankuesit është në vlerë prej **174,084.00 euro**, ndërsa oferta e operatorit tjetër ishte **208,900.80 euro**. Diferenca prej **34,816.80 euro** përbën ndikim të drejtpërdrejtë në përdorimin ekonomik të fondeve publike. Eliminimi arbitrar i tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe anulimi i procedurës cenojnë qëllimin themelor të LPP-së, konkurrencën efektive dhe interesin financiar të Autoritetit Kontraktues.

Për pasojë, vendimet e datave 25.08.2026 dhe 04.09.2026 nuk mund të mbeten në fuqi. Ato duhet të anulohen nga OSHP-ja dhe aktiviteti i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim, me urdhër të qartë që oferta e Ankuesit të shqyrtohet mbi bazën e përmbajtjes së dokumenteve, parametrave teknikë realë dhe dispozitave të LPP-së, pa kritere të papublikuara dhe pa interpretime arbitrare.

Vendimmarrja e AK-së nuk përbën thjesht vlerësim me të cilin Ankuesi nuk pajtohet. Ajo përbën cenim material të ligjshmërisë së procedurës, të barazisë ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe të përdorimit ekonomik të parasë publike, me pasojë dëmtimin e drejtpërdrejtë të Ankuesit dhe humbjen e mundësisë reale për fitimin e kontratës.

KRONOLOGJIA E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT

1. Autoriteti Kontraktues – Komuna e Mitrovicës Jugore, më **18.06.2026**, publikoi aktivitetin e prokurimit me titull **“Shërbimet e pastrimit të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve”**, me numër prokurimi **642-26-4703-2-1-1**, ndërsa hapja e ofertave u realizua më **28.07.2026**.

Kriteri për dhënien e kontratës ishte **“tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”**. Për rrjedhojë, AK-ja ishte e detyruar që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ta zhvillonte në mënyrë objektive, transparente dhe të barabartë, në përputhje me nenet 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së.

1. Më **06.08.2026**, AK-ja publikoi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin rekomandoi

për dhënie të kontratës OE **SELMANS NETWORK SH.P.K.**, me çmim të ofertuar prej **208,900.80 euro**, ndërsa eliminoi pa bazë ligjore GOE **MEB L.L.C. & CPS Phoenix Group L.L.C.**, oferta e të cilit ishte në vlerë prej vetëm **174,084.00 euro**.

Eliminimi i Ankuesit u mbështet në interpretime formaliste dhe të pabazuara lidhur me pajisjen e deklaruar në ofertë dhe vlefshmërinë e tenderit prej 365 ditësh, pavarësisht se pajisja ishte deklaruar dhe dokumentuar, ndërsa vlefshmëria e ofertës e tejkalonte periudhën prej 90 ditësh të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Në të njëjtën kohë, AK-ja rekomandoi për kontratë një operator oferta financiare e të cilit përmbante mospërputhje materiale ndërmjet çmimit për njësi, TVSH-së, çmimit me TVSH dhe çmimit të përgjithshëm të ofertës.

1. Kundër vendimit të datës 06.08.2026, Ankuesi, brenda afatit ligjor, më **10.08.2026**, paraqiti Kërkesën e parë për Rishqyrtim, të argumentuar dhe të mbështetur me prova konkrete.

Në këtë kërkesë, Ankuesi nuk kishte ngritur pretendime vetëm kundër përgjegjshmërisë së ofertës së OE **SELMANS NETWORK SH.P.K.**, por kishte paraqitur edhe pretendime të veçanta dhe të argumentuara kundër **eliminimit të ofertës së vet**, përfshirë:

- përmbushjen e Kërkesës nr. 5 lidhur me pajisjet, mjetet dhe stabilimentet;
- dokumentacionin teknik dhe provat për pajisjen e deklaruar;
- karakteristikat dhe funksionalitetin e pajisjes;
- vlefshmërinë e tenderit prej 365 ditësh;
- dhe trajtimin e pabarabartë të ofertave.

1. Me Vendimin e datës **11.08.2026**, AK-ja e **aprovoi pjesërisht si të bazuar Kërkesën për Rishqyrtim**, anuloi njoftimin paraprak mbi vendimin dhe e ktheu aktivitetin në rivlerësim.

Megjithatë, AK-ja trajtoi vetëm pretendimet lidhur me gabimet financiare të OE **SELMANS NETWORK SH.P.K.**, **ndërsa nuk shqyrtoi dhe nuk dha përgjigje për pretendimet vendimtare që lidheshin me eliminimin e ofertës së Ankuesit.**

Në vendimin e datës 11.08.2026, AK-ja:

- nuk shqyrtoi bazën faktike dhe juridike të eliminimit të Ankuesit;
- nuk vlerësoi dokumentacionin teknik dhe provat e dorëzuara;
- nuk dha përgjigje për pajisjen e deklaruar;
- nuk dha përgjigje për vlefshmërinë e tenderit prej 365 ditësh;
- nuk vendosi mbi pretendimin për trajtim të pabarabartë;
- dhe nuk vendosi mbi kërkesën që oferta e Ankuesit të shpallej e përgjegjshme.

Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të **nenit 108/A, paragrafëve 10 dhe 12 të LPP-së**, sepse Autoriteti Kontraktues është i detyruar ta shqyrtojë kërkesën për rishqyrtim në tërësinë e saj dhe të nxjerrë vendim

konkretisht të arsyetuar për pretendimet e ngritura.

Aprovimi i vetëm një pjese të kërkesës nuk e lironte AK-në nga detyrimi për të vendosur shprehimisht edhe për pretendimet e tjera. Nëse AK-ja konsideronte se pretendimet kundër eliminimit të Ankuesit ishin të pabazuara, ajo ishte e detyruar:

1. t'i identifikonte individualisht pretendimet;
2. t'i ballafaqonte ato me provat e dorëzuara;
3. të përcaktonte faktet e vërtetuara;
4. të tregonte dispozitat ligjore të zbatueshme; dhe
5. të jepte arsye konkrete për pranimin ose refuzimin e secilit pretendim.

AK-ja nuk ka kryer asnjërin prej këtyre veprimeve. **Heshtja ndaj pretendimeve nuk mund të konsiderohet refuzim i nënkuptuar dhe as arsyetim juridik.**

Ky mosshqyrtim cenon edhe **nenet 7, 59 dhe 60 të LPP-së**, parimin e transparencës, sigurinë juridike dhe të drejtën e operatorit ekonomik për mbrojtje efektive juridike.

1. Gjatë rivlerësimit u konfirmua se oferta e OE SELMANS NETWORK SH.P.K. ishte e papërgjegjshme për shkak të gabimeve në ofertën financiare. Korrigjimi i gabimit aritmetik rezultonte në ndryshim prej **6,963.36 euro**, përkatësisht rreth **3.33%** të vlerës së ofertës prej 208,900.80 euro, duke e tejkaluar kufirin e lejuar prej **2%**.

Oferta e këtij operatori nuk mund të korrigjohej pa ndryshuar përmbajtjen materiale dhe ekonomike të tenderit pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave, në kundërshtim me **nenet 59 dhe 72 të LPP-së** dhe me dispozitat për korrigjimin e gabimeve aritmetike.

Pas eliminimit të OE SELMANS NETWORK SH.P.K., në procedurë mbetej oferta e Ankuesit në vlerë prej **174,084.00 euro**, e cila ishte:

- oferta me çmimin më të ulët;
 - financiarisht e rregullt;
 - teknikisht e dokumentuar;
 - e vlefshme për një periudhë më të gjatë se minimumi i kërkuar;
 - dhe e aftë për përmbushjen e kontratës.
1. Pavarësisht kësaj gjendjeje faktike dhe juridike, AK-ja, në vend që ta vlerësonte objektivisht ofertën e Ankuesit dhe ta zbatonte kriterin e dhënies së kontratës, më **25.08.2026** vendosi ta **anulonte tërësisht aktivitetin e prokurimit**.

Anulimi u mbështet në nenin 43.5(b) të Rregullores për Prokurimin Publik, me arsyetimin se asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk ishte i përgjegjshëm. Mirëpo, kjo premisë faktike është krijuar artificialisht përmes eliminimit të

kundërligjshëm të ofertës së Ankuesit. AK-ja nuk mund ta përdorë anulimin si instrument për të ruajtur pasojat e një vlerësimi të paligjshëm dhe për të shmangur dhënien e kontratës operatorit ekonomik që, pas eliminimit të ofertës së papërgjegjshme të operatorit të rekomanduar fillimisht, rezulton të ketë tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Veçanërisht e rëndë është rrethana se AK-ja e përdori përsëri eliminimin e Ankuesit si bazë për anulim, ndonëse në vendimin e datës 11.08.2026 kishte dështuar të shqyrtonte dhe të vendoste mbi pretendimet që kundërshtonin pikërisht atë eliminim.

Pra, AK-ja e ka përdorur si fakt të përfunduar një çështje të cilën nuk e kishte shqyrtuar dhe arsyetuar ligjërisht. Kjo përbën:

- **shkelje esenciale procedurale;**
- **kundërthënie në vendimmarrje;**
- **cenim të sigurisë juridike;**
- **mohim të mbrojtjes efektive juridike;**
- **dhe shkelje të nenit 108/A të LPP-së.**

Sikur AK-ja t'i kishte shqyrtuar ligjërisht të gjitha pretendimet e Kërkesës së parë për Rishqyrtim, ajo do të duhej të konstatonte që në atë fazë se arsyet e eliminimit të Ankuesit ishin të pabazuara dhe, pas eliminimit të SELMANS NETWORK SH.P.K., të vazhdonte me zbatimin e kriterit për dhënien e kontratës.

1. Kundër vendimit për anulim, Ankuesi paraqiti Kërkesën e dytë për Rishqyrtim, në të cilën argumentoi në mënyrë të detajuar se oferta e tij ishte eliminuar në mënyrë të kundërligjshme dhe se nuk ekzistonte kushti faktik dhe juridik për anulimin e aktivitetit sipas nenit 43.5(b) të Rregullores për Prokurimin Publik.

Megjithatë, më **04.09.2026**, AK-ja e refuzoi kërkesën si të pabazuar dhe vendosi ta vazhdonte anulimin e aktivitetit.

Edhe ky vendim nuk përmban shqyrtim të mirëfilltë juridik dhe teknik të pretendimeve. AK-ja:

- nuk i ballafaqoi pretendimet me provat konkrete;
- nuk identifikoi parametrin teknik që pretendohet se mungon;
- nuk kreu analizë profesionale të pajisjes;
- nuk shpjegoi pse vlefshmëria prej 365 ditësh nuk e përmbush periudhën prej 90 ditësh;
- nuk arsyetoi karakterin material të mospërputhjeve të pretenduara;
- dhe nuk tregoi pse praktika relevante e OSHP-së nuk ishte e zbatueshme.

Në vend të një arsyetimi të individualizuar, AK-ja përdori formulime të përgjithshme, përsëritje mekanike dhe përfundime deklarative. Gabimet në emërtimin e operatorëve dhe përsëritja e titujve të pretendimeve e përforcojnë dyshimin se nuk është zhvilluar një shqyrtim real dhe përmbajtjesor.

1. Kronologjia dëshmon një model të qartë të vendimmarrjes së kundërligjshme;
2. Fillimisht u rekomandua për kontratë një ofertë me gabime financiare mbi kufirin e lejuar;
3. Pas kërkesës së Ankuesit u pranua nevoja për rivlerësim;
4. AK-ja nuk u përgjigj fare ndaj pretendimeve që kundërshtonin eliminimin e Ankuesit;
5. Pasi operatori i rekomanduar u konstatua i papërgjegjshëm, procedura u anulua;
6. Si bazë për anulim u përdor pikërisht eliminimi për të cilin AK-ja nuk kishte dhënë vendim të arsyetuar; dhe
7. Kërkesa e dytë për Rishqyrtim u refuzua pa u administruar dhe vlerësuar drejt provat e Ankuesit.

Këto veprime nuk përbëjnë mangësi të parëndësishme administrative, por **shkelje esenciale me ndikim vendimtar në rezultatin e aktivitetit të prokurimit**.

Prandaj, vendimet e datave **25.08.2026** dhe **04.09.2026** janë nxjerrë mbi një procedurë të cenuar nga mosshqyrtimi i pretendimeve, konstatimi i gabuar i fakteve, zbatimi selektiv i standardeve dhe interpretimi arbitrar i Dosjes së Tenderit.

I. SHKELJET LIGJORE TË AK-SË

A. Shkelja e parë kyçe: Interpretimi arbitrar dhe i kundërligjshëm i afatit të vlefshmërisë së tenderit

Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar GOE Ankues me arsyetimin se në Formularin e Tenderit është deklaruar vlefshmëria prej **365 ditësh**, ndërsa Dosja e Tenderit kishte përcaktuar vlefshmëri prej **90 ditësh**. Ky përfundim është juridikisht i gabuar, logjikisht i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me vetë qëllimin e institutit të vlefshmërisë së tenderit.

1. Dosja e Tenderit sanksionon vlefshmërinë më të shkurtër, jo vlefshmërinë më të gjatë

Sipas kushteve administrative të Dosjes së Tenderit dhe rregullave të prokurimit publik:

“Tenderi që është valid për një periudhë më të shkurtër se periudha e kërkuar do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues si i papërgjegjshëm.”

Formulimi është i qartë dhe nuk lejon interpretimin e përdorur nga AK-ja. Shkak për refuzim është vlefshmëria **më e shkurtër** se periudha e kërkuar, sepse ajo rrezikon që oferta të skadojë para përfundimit të procedurës.

Në rastin konkret:

- periudha e kërkuar ishte 90 ditë;
- Ankuesi ka deklaruar 365 ditë;
- oferta ka qenë e vlefshme gjatë secilës prej 90 ditëve të kërkuara;
- dhe Ankuesi ka marrë përsipër të mbetet i lidhur me ofertën edhe për 275 ditë shtesë.

AK-ja po përpiqet ta shndërrojë një obligim më të madh të tenderuesit në shkak eliminimi, pa pasur asnjë dispozitë

të LPP-së, Rregullores apo Dosjes së Tenderit që parashikon një sanksion të tillë.

2. AK-ja e ka shndërruar në mënyrë të kundërligjshme një afat minimal në afat fiks dhe maksimal

Në vendimin e datës 04.09.2026, AK-ja pretendon se operatori është dashur ta deklarojë “saktësisht” periudhën prej 90 ditësh.

Mirëpo, Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar:

- se periudha prej 90 ditësh është afat maksimal;
- se vlefshmëria duhet të jetë saktësisht dhe vetëm 90 ditë;
- se ndalohet deklarimi i një periudhe më të gjatë;
- apo se vlefshmëria mbi 90 ditë përbën shkak për eliminim.

Duke kërkuar pas hapjes së ofertave që vlefshmëria të ishte “saktësisht 90 ditë”, AK-ja ka krijuar një kusht të ri eliminues që nuk ishte publikuar në Dosjen e Tenderit. Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me **nenin 56.3 të LPP-së**, sipas të cilit tenderuesi nuk mund të diskualifikohet ose përjashtohet mbi bazën e një kërkesë apo kriteri që nuk është përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

AK-ja nuk mund ta plotësojë apo ndryshojë kuptimin e Dosjes pas hapjes së ofertave dhe më pas ta përdorë interpretimin e vet të ri si bazë për eliminim.

3. Vlefshmëria prej 365 ditësh nuk përbën devijim material

Sipas **nenit 59.4 të LPP-së** dhe **nenit 40.6 të Rregullores Nr. 001/2022**, një tender vlerësohet sipas përputhshmërisë së tij materiale me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Edhe gabimet, paqartësitë ose devijimet e vogla që nuk ndryshojnë një kusht material nuk e bëjnë automatikisht tenderin të papërgjegjshëm.

Vlefshmëria prej 365 ditësh:

- nuk e ndryshon çmimin;
- nuk e ndryshon ofertën financiare;
- nuk ndryshon specifikimet teknike;
- nuk e kufizon asnjë të drejtë të AK-së;
- nuk zvogëlon asnjë obligim të tenderuesit;
- nuk ndikon në fushëveprimin, cilësinë ose realizimin e kontratës;
- nuk cenon pozitën e operatorëve të tjerë;
- nuk krijon avantazh të padrejtë;
- dhe nuk e shtrembëron konkurrencën.

Përkundrazi, ajo e zgjat periudhën gjatë së cilës Ankuesi mbetet juridikisht i lidhur me çmimin dhe kushtet e ofertës së tij. Kjo përbën siguri shtesë për AK-në, veçanërisht në rast të zgjatjes së procedurës për shkak të mjeteve

juridike.

Prandaj, AK-ja nuk ka treguar dhe as nuk mund të tregojë se cili aspekt material i tenderit është cenuar.

4. Arsyetimi i AK-së nuk e kalon testin e materialitetit dhe proporcionalitetit

Nëse AK-ja pretendon se vlefshmëria prej 365 ditësh përbën devijim material, ajo ka barrën që të shpjegojë:

1. cilën të drejtë konkrete të AK-së e kufizon;
2. cilin obligim të Ankuesit e zvogëlon;
3. cilën pjesë të kontratës e ndryshon;
4. çfarë përparësie të padrejtë krijon;
5. dhe në çfarë mënyre ndikon në rezultatin e procedurës.

Vendimi i datës 04.09.2026 nuk jep përgjigje për asnjërën nga këto çështje. Ai kufizohet në konstatimin se 365 ditë “nuk janë periudha e njëjtë” me 90 ditë.

Ky nuk është arsyetim juridik. Është vetëm një krahasim numerik, i përdorur jashtë qëllimit të kërkesës dhe në dëm të operatorit ekonomik.

5. AK-ja ka shpërfillur praktikën drejtpërdrejt relevante të OSHP-së

Ankuesi ka cituar Vendimin e OSHP-së nr. **2025/0418**, të datës 21.07.2025, në të cilin është trajtuar një situatë e krahasueshme: kërkohej vlefshmëri prej 30 ditësh, ndërsa operatori kishte deklaruar dy muaj.

Në atë rast ishte konstatuar se vlefshmëria më e gjatë:

- e përmbush afatin minimal;
- nuk cenon konkurrencën;
- nuk krijon përparësi të padrejtë;
- dhe përbën angazhim shtesë të operatorit.

AK-ja e ka refuzuar zbatimin e këtij vendimi vetëm me formulimin e përgjithshëm se “çdo procedurë vlerësohet sipas rrethanave konkrete”, por nuk ka identifikuar asnjë dallim material ndërmjet dy rasteve. **Mohimi deklarativ i një precedenti pa analizuar ngjashmëritë dhe dallimet faktike nuk përbën arsyetim. AK-ja është dashur të shpjegojë pse standardi juridik sipas të cilit afati më i gjatë e përmbush afatin minimal nuk zbatohet në rastin konkret.**

Eliminimi i Ankuesit për vlefshmërinë prej 365 ditësh është në kundërshtim me:

- *nenin 7 të LPP-së;*
- *nenin 56.3 të LPP-së;*
- *nenin 59.4 të LPP-së;*

- *nenin 60.1.1 të LPP-së;*
- *nenet 40.6 dhe 40.7 të Rregullores Nr. 001/2022;*
- *Dosjen e Tenderit;*
- *dhe praktikën relevante të OSHP-së.*

Ky eliminim nuk ka bazë ligjore. Ai mbështetet në një kusht të papublikuar dhe në një interpretim që e ndëshkon operatorin ekonomik pikërisht sepse i ka ofruar AK-së siguri më të gjatë sesa minimumi i kërkuar.

B. SHKELJA E DYTË KYÇE: SHPËRFILLJA E SQARIMIT ZYRTAR TË AK-së, VLERËSIMI ARBITRAR I PAJISJES DHE PËRDORIMI I NJË KRITERI TË PAPUBLIKUAR

Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar GOE Ankues me pretendimin se nuk është përmbushur pozicioni nr. 1 i Aneksit 7, ku është kërkuar:

“Kamion me korpë – lartësia e korpës arrin deri në 40 metra – 1 copë, me librezë valide.”

Si arsye eliminuese, AK-ja ka përdorur faktin se pajisja e deklaruar nga Ankuesi në dokumentacionin e regjistrimit evidentohet si **“automjet special me vinç”**, dhe jo me emërtimin tekstual **“kamion me korpë”**. Ky konstatim është rezultat i një vlerësimi të paplotë, formalist dhe teknikisht të paargumentuar. AK-ja ka shpërfillur:

- sqarimin e vet zyrtar të dhënë para hapjes së tenderëve;
- qëllimin funksional të pajisjes;
- dokumentacionin teknik të dorëzuar nga Ankuesi;
- parametrat realë të pajisjes;
- të drejtën e përdorimit të saj gjatë kontratës;
- dhe mundësinë ligjore për sqarimin e çdo paqartësie eventuale.

1. Vetë AK-ja, para hapjes së tenderëve, e ka përcaktuar qëllimin funksional të pajisjes

Gjatë periudhës për përgatitjen e ofertave dhe para hapjes së tenderëve, një operator ekonomik i interesuar ka kërkuar sqarim nga AK-ja lidhur me nevojën dhe qëllimin e kërkesës për **“kamion me korpë”**. Në përgjigjen e vet zyrtare, AK-ja ka sqaruar se kjo pajisje kërkohej për realizimin e **pastrimit të xhamave dhe sipërfaqeve në lartësi**.

Ky sqarim ka rëndësi vendimtare juridike dhe teknike. Përmes tij, vetë AK-ja ka përcaktuar se qëllimi i kërkesës nuk ishte posedimi i një automjeti që në librezë mban vetëm një emërtim të caktuar administrativ, por sigurimi i kapacitetit teknik për:

- arritjen e lartësisë së kërkuar;
- qasjen në fasada, dritare dhe sipërfaqe të larta;
- realizimin e pastrimit të xhamave;

- dhe kryerjen e sigurt të shërbimit.

Sqarimi i publikuar para hapjes së ofertave bëhet pjesë e dokumentacionit të procedurës dhe përcakton mënyrën sipas së cilës operatorët ekonomikë e kuptojnë dhe e përgatisin ofertën.

AK-ja është juridikisht e lidhur me sqarimin e vet. Ajo nuk mund:

1. para hapjes së ofertave, ta paraqesë kërkesën si kërkesë funksionale për pastrimin e xhamave në lartësi;
2. t'i lejojë operatorët t'i përgatisin ofertat mbi bazën e atij sqarimi; dhe
3. pas hapjes së ofertave, ta shndërrojë të njëjtën kërkesë në kusht formal që pajisja duhet të ketë një emërtim **të caktuar në librezë.**

Një ndryshim i tillë pas hapjes së ofertave cenon parashikueshmërinë, transparencën dhe sigurinë juridike të procedurës.

2. AK-ja nuk mund ta mohojë pas hapjes së ofertave interpretimin që vetë e ka dhënë para hapjes

Sqarimi i AK-së ka krijuar pritje të ligjshme se pajisjet do të vlerësoheshin sipas funksionit për të cilin kërkoheshin: pastrimit të xhamave në lartësi.

Operatorët ekonomikë kanë pasur të drejtë të mbështeten në atë sqarim gjatë përgatitjes së ofertave. AK-ja nuk mund të ndryshojë standardin e vlerësimit pasi ka parë:

- identitetin e ofertuesve;
- dokumentacionin e tyre;
- dhe çmimet e ofertave.

Përdorimi pas hapjes së tenderëve i një interpretimi më të ngushtë sesa ai që AK-ja kishte komunikuar para hapjes cenon drejtpërdrejt **nenin 7 të LPP-së**, sepse krijon një procedurë të paparashikueshme dhe mundëson zbatim selektiv të kushteve.

AK-ja nuk mund të thotë një gjë gjatë fazës së tenderimit dhe ta zbatojë të kundërtën gjatë vlerësimit. Një sjellje e tillë bie ndesh me parimet e transparencës, konsistencës administrative dhe mbrojtjes së pritjeve të ligjshme të operatorëve ekonomikë.

3. Pajisja e Ankuesit përmbush qëllimin funksional të sqaruar nga AK-ja

GOE Ankues ka deklaruar dhe dokumentuar pajisjen **DEMAG AC205**, me këto karakteristika:

- krah bazë teleskopik prej 50 metrash;
- shtojcë Jib prej 17 metrash;
- shtrirje maksimale operative deri në 67 metra;
- stabilizatorë hidraulikë;

- sistem rrotullues 360 gradë;
- mekanizëm profesional ngritës;
- sistem komandimi dhe kontrolli;
- si dhe pajisje sigurie kundër mbingarkesës.

Krahasuar me lartësinë prej 40 metrash të përmendur në Aneksin 7, pajisja e Ankuesit ka shtrirje teknike të dokumentuar që e tejkalon atë deri në **27 metra**.

Dokumentacioni i ofertës e lidh shprehimisht këtë pajisje me:

- pastrimin e fasadave të xhamit;
- pastrimin e dritareve në objekte shumëkatëshe;
- pastrimin e kupolave dhe sipërfaqeve të larta;
- dhe ndërhyrjet në lartësi.

Prandaj, pajisja e deklaruar i **përgjigjet pikërisht qëllimit funksional** që AK-ja e **kishte sqaruar para hapjes së tenderëve**.

Nëse AK-ja pretendon të kundërtën, ajo ishte e detyruar të tregonte me analizë teknike:

- pse pajisja nuk mund të përdoret për pastrimin e xhamave;
- cili element teknik mungon;
- cili dokument e provon papërshtatshmërinë;
- dhe pse kapaciteti dhe shtrirja e dokumentuar nuk mjaftojnë për realizimin e shërbimit.

AK-ja nuk e ka bërë këtë.

4. Vendimi i AK-së mbështetet në emërtim, jo në analizë teknike

Në vendimin e kundërshtuar, AK-ja nuk paraqet:

- ekspertizë teknike;
- mendim të ndonjë eksperti të makinerisë;
- analizë të diagramit të punës;
- analizë të fotografive;
- analizë të mekanizmit ngritës;
- apo krahasim ndërmjet kërkesës funksionale dhe karakteristikave të pajisjes.

Në vend të kësaj, AK-ja e redukton tërë vlerësimin teknik në dallimin terminologjik ndërmjet “kamionit me korpë” dhe “automjetit special me vinç”. Ky nuk është ekzaminim teknik në kuptim të **nenit 59 të LPP-së**. Është zëvendësim i analizës profesionale me një supozim administrativ.

Një komision vlerësues nuk mund ta shpallë një pajisje teknikisht të papërshtatshme vetëm nga emërtimi në

librezë, pa e analizuar dokumentacionin që përshkruan kapacitetin, shtrirjen dhe funksionalitetin e saj.

5. AK-ja ka krijuar pas hapjes së ofertave një kriter të ri eliminues

Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar:

- markën;
- modelin;
- prodhuesin;
- emërtimin që duhet të figurojë në librezë;
- llojin e veçantë të mekanizmit ngritës;
- formulimin teknik të certifikatës së regjistrimit;
- apo ndalimin e përdorimit të një automjeti special që realizon funksionin e kërkuar.

Edhe sqarimi i AK-së para hapjes nuk ka thënë se në librezën e automjetit duhet të figurojë domosdoshmërisht termi “kamion me korpë”. Përkundrazi, AK-ja ka thënë se pajisja nevojitet për pastrimin e xhamave në lartësi.

Prandaj, përdorimi i emërimit në librezë si kusht i pavarur eliminues përbën kriter të papublikuar.

Kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e **nenit 56.3 të LPP-së**, sipas të cilit tenderuesi nuk mund të diskualifikohet ose përjashtohet mbi bazën e një kërkesë apo kriteri që nuk është përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

AK-ja mund ta vlerësojë ofertën vetëm sipas asaj që ka kërkuar dhe sqaruar paraprakisht, jo sipas asaj që pas hapjes pretendon se ka pasur ndërmend të kërkojë.

6. Specifikimet teknike duhet të interpretohen sipas funksionit dhe qëllimit të prokurimit

Sipas **nenit 28 të LPP-së**, specifikimet teknike duhet të lidhen me qëllimin e prokurimit dhe të sigurojnë qasje të barabartë për operatorët ekonomikë. Kur kërkesa përcaktohet përmes funksionit ose rezultatit të kërkuar, vlerësimi duhet të përqendrohet në aftësinë e zgjidhjes së ofertuar për ta realizuar atë funksion.

Në rastin konkret, pyetja juridikisht relevante nuk është:

“A figuron në librezë pikërisht shprehja ‘kamion me korpë’?”

Pyetja relevante është:

“A është deklaruar dhe dokumentuar brenda ofertës një pajisje që arrin lartësinë e kërkuar dhe mundëson realizimin e pastrimit të xhamave në lartësi, sipas qëllimit të sqaruar nga vetë AK-ja?”

AK-ja nuk i është përgjigjur kësaj pyetjeje. Ajo ka shmangur analizën e funksionit sepse dokumentacioni teknik i Ankuesit e kundërshton përfundimin e saj eliminues.

7. AK-ja ka ngatërruar parametrin e peshës me parametrin e lartësisë

Në arsyetimin e AK-së përdoret edhe referimi në kapacitetin prej “48 tonësh”. Mirëpo, pesha e lejuar e automjetit, kapaciteti ngritës dhe lartësia e shtrirjes së krahut janë parametra të ndryshëm teknikë.

Fakti që në dokumentin e regjistrimit figuron pesha prej 48,000 kg nuk provon se pajisja:

- nuk arrin 40 metra;
- nuk mund të përdoret për punë në lartësi;
- ose nuk e realizon pastrimin e xhamave.

Për të konstatuar lartësinë, AK-ja duhej të analizonte dokumentacionin teknik të krahut teleskopik dhe shtojcës Jib. Ky dokumentacion tregon shtrirje deri në 67 metra.

Prandaj, AK-ja ka nxjerrë përfundim teknik mbi bazën e një parametri që nuk e provon atë përfundim. Kjo përbën konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

8. Barra për arsyetimin e eliminimit i takon AK-së

GOE Ankues ka dorëzuar pajisjen në listë, dokumentet identifikuese, marrëveshjen për vënien në dispozicion, të dhënat teknike dhe fotografitë. Pas dorëzimit të këtyre provave, AK-ja nuk mund të mjaftohej me deklarin se pajisja “nuk është e njëjtë”. Ajo duhej të identifikonte:

1. kriterin e saktë të papërmbushur;
2. provën mbi të cilën mbështetet;
3. dokumentin e Ankuesit që e ka refuzuar;
4. arsyen teknike për refuzim;
5. ndikimin material në ekzekutimin e kontratës;
6. dhe pamundësinë e sqarimit të çështjes pa ndryshuar ofertën.

Asnjëra nga këto nuk është arsyetuar.

Në mungesë të kësaj analize, vendimi është i pakontrollueshëm juridikisht dhe nuk i plotëson standardet minimale të një vendimi të arsyetuar sipas **nenit 108/A të LPP-së**.

9. AK-ja kishte mundësi dhe detyrim ta sqaronte paqartësinë eventuale

Sipas **nenit 59.2 të LPP-së**, AK-ja mund të kërkojë sqarim me shkrim për cilindo aspekt të tenderit, pa lejuar ndryshimin e ndonjë elementi material.

Sipas **nenit 72 të LPP-së**, AK-ja mund ta ftojë operatorin ekonomik të plotësojë ose qartësojë certifikatat dhe dokumentet e dorëzuara në pajtim me nenet 65-71, përfshirë dokumentet për aftësinë teknike sipas nenit 69.

Në këtë rast, sqarimi:

- nuk do të shtonte pajisje të re;
- nuk do ta zëvendësonte pajisjen;
- nuk do të ndryshonte listën e pajisjeve;
- nuk do të krijonte kapacitet të ri;
- nuk do të ndryshonte çmimin;
- dhe nuk do të ndryshonte ofertën materiale.

Do të sqarohej vetëm aftësia funksionale e pajisjes së deklaruar para afatit.

Praktika vendimmarrëse e OSHP-së bën dallim ndërmjet plotësimit të ndaluar material të ofertës dhe sqarimit të lejuar të një fakti apo dokumenti ekzistues. Kur pajisja dhe kapaciteti janë deklaruar brenda ofertës, verifikimi i karakteristikave të saj nuk përbën zëvendësim ose përmirësim të ofertës.

Nëse AK-ja pretendon se ka kërkuar sqarim, ajo duhet ta dorëzojë dhe ta analizojë:

- kërkesën e plotë për sqarim;
- përgjigjen e Ankuesit;
- dokumentet e bashkëngjitura;
- dhe arsyet konkrete për mospranimin e secilës provë.

Referimi i përgjithshëm se “është kërkuar sqarim” nuk përbën shqyrtim dhe nuk e përmbush detyrimin për arsyetim.

10. Mosparashtrimi i pyetjes para tenderimit nuk mund të përdoret kundër Ankuesit

AK-ja pretendon se Ankuesi ka mundur të kërkonte sqarime para dorëzimit të ofertës, nëse e konsideronte kriterin të paqartë. Ky arsyetim është i pambështetur, sepse sqarimi ishte kërkuar tashmë nga një operator ekonomik dhe AK-ja kishte dhënë përgjigje: pajisja nevojitej për pastrimin e xhamave në lartësi.

Ankuesi nuk kishte asnjë detyrim të përsëriste një pyetje për të cilën AK-ja kishte dhënë përgjigje zyrtare.

Përkundrazi, Ankuesi kishte të drejtë të mbështetej në sqarimin e publikuar dhe ta përgatiste ofertën sipas funksionit të komunikuar. AK-ja nuk mund ta përdorë kundër Ankuesit faktin se ai i ka besuar përgjigjes zyrtare të vetë AK-së. Një qasje e tillë do ta bënte procesin e sqarimeve të pavlefshëm dhe do ta cenonte sigurinë juridike të të gjithë operatorëve ekonomikë.

11. Zbatimi i standardit të dyfishtë dhe favorizimi faktik i operatorit tjetër

Nga dokumentacioni rezulton se ndaj OE SELMANS NETWORK SH.P.K., AK-ja ka qenë e gatshme:

- të shqyrtojë deklaratimet lidhur me lartësinë e pajisjes;

- të pranojë dokumentacion që kërkonte verifikim shtesë;
- dhe ta vlerësojë pajisjen sipas funksionit dhe kapacitetit të pretenduar.

Ndërsa ndaj Ankuesit:

- është shpërfillur sqarimi funksional i AK-së;
- është refuzuar dokumentacioni teknik pa analizë;
- është përdorur vetëm emërtimi formal në librezë;
- dhe nuk është verifikuar shtrirja e pajisjes.

Kjo përbën standard të dyfishtë dhe shkelje të **nenit 7.1 dhe 7.2 të LPP-së**, i cili kërkon trajtim të barabartë, jodiskriminues dhe transparent dhe ndalon zhvillimin e aktivitetit në mënyrë që diskriminon në dëm ose në dobi të një operatori ekonomik.

Dyshimi forcohet nga fakti se një dokument regjistrimi i lidhur me pajisjen e SELMANS NETWORK mban datën **07.08.2026**, pra:

- pas afatit për dorëzimin e ofertave më 28.07.2026; dhe
- pas vendimit fillestar të AK-së më 06.08.2026.

AK-ja duhet të sqarojë:

1. cili dokument për pajisjen e SELMANS ka qenë pjesë e ofertës më 28.07.2026;
2. në çfarë date ka qenë valide librezë e pajisjes;
3. nëse dokumenti i datës 07.08.2026 është dorëzuar pas afatit;
4. dhe mbi cilën provë AK-ja e kishte konstatuar përgjegjshmërinë e operatorit para nxjerrjes së vendimit të datës 06.08.2026.

Nëse dokumenti i datës 07.08.2026 është përdorur për ta plotësuar pas afatit një kriter që nuk ishte përmbushur më 28.07.2026, kemi ndryshim material të ofertës dhe trajtim dukshëm të pabarabartë. AK-ja nuk mund t’ia refuzojë Ankuesit interpretimin funksional të një pajisjeje të deklaruar brenda afatit, ndërsa operatorit tjetër t’i pranojë dokumente materiale të krijuara ose dorëzuara pas afatit.

Ky trajtim selektiv krijon dyshim serioz, objektiv dhe të arsyeshëm se procedura është orientuar drejt ruajtjes së pozitës së operatorit të rekomanduar fillimisht dhe eliminimit të ofertës së Ankuesit, e cila ishte **34,816.80 euro më e lirë**.

12. AK-ja nuk mund ta përdorë paqartësinë e vet kundër operatorit ekonomik

Nëse formulimi “kamion me korpë – lartësia deri në 40 metra” nuk ka përcaktuar mjaftueshëm:

- konfigurimin teknik;

- llojin e platformës;
- mënyrën e ngritjes së personave;
- certifikimin e korpës;
- apo emërtimin në librezë,

kjo është pasojë e mënyrës se si AK-ja e ka hartuar kërkesën.

Paqartësia e krijuar nga AK-ja nuk mund të interpretohet pas hapjes në mënyrën më kufizuese ndaj operatorit ekonomik, veçanërisht kur sqarimi i publikuar e kishte orientuar kriterin drejt funksionit të pastrimit të xhamave.

AK-ja nuk mund të përfitojë juridikisht nga paqartësia që vetë e ka krijuar dhe as ta përdorë atë si instrument eliminimi.

13. Praktika e OSHP-së dhe standardi i shqyrtimit

Nga praktika e konsoliduar vendimmarrëse e OSHP-së, e mbështetur në nenet 7, 52, 56, 59, 69, 72 dhe 108/A të LPP-së, rezultojnë disa parime themelore dhe detyruese:

- tenderi duhet të vlerësohet vetëm sipas kriterëve dhe kërkesave të publikuara paraprakisht në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit;
- operatori ekonomik nuk mund të eliminohet mbi bazën e një kushti, kriteri, emërtimi apo kërkesë që nuk është përcaktuar qartë para hapjes së ofertave;
- sqarimi i përmbajtjes së dokumenteve dhe kapaciteteve të deklaruara brenda afatit duhet të dallohet nga ndryshimi ose plotësimi material i tenderit;
- vendimi eliminues duhet të mbështetet në fakte të verifikuara, prova konkrete dhe arsyetim të individualizuar;
- i njëjti standard juridik dhe teknik duhet të zbatohet ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë;
- paqartësia ose devijimi mund të prodhojë eliminim vetëm nëse është material dhe ndikon realisht në çmim, cilësi, fushëveprim, ekzekutim, konkurrencë apo në të drejtat e AK-së;
- dhe çdo përfundim teknik duhet të mbështetet në analizë profesionale, jo në supozime apo krahasime thjesht terminologjike.

Këto parime nuk janë udhëzime fakultative që AK-ja mund t'i zbatojë sipas vlerësimit të vet. Ato burojnë drejtpërdrejt nga dispozitat detyruese të LPP-së dhe përbëjnë standardin minimal të ligjshmërisë së çdo procesi të ekzaminimit dhe vlerësimit.

Në rastin konkret, AK-ja ka vepruar në kundërshtim me secilin prej këtyre standardeve. AK-ja nuk ka provuar se pajisja e Ankuesit është teknikisht e papërshtatshme. Ajo vetëm e ka supozuar papërshtatshmërinë nga fakti se në dokumentacionin e regjistrimit pajisja figuron me emërtimin “automjet special me vinç” dhe jo tekstualisht “kamion me korpë”.

Një supozim i tillë nuk mund ta mbështesë eliminimin e një tenderi. Emërtimi administrativ nuk është provë

teknike dhe nuk mund ta zëvendësojë analizën e:

- konstrukcionit dhe mekanizmit të pajisjes;
- shtrirjes së krahut teleskopik;
- lartësisë operative;
- pajisjeve përcjellëse;
- dokumentacionit teknik;
- fotografive;
- dhe aftësisë reale për ta kryer shërbimin e kërkuar.

Veçanërisht rëndues është fakti se, para hapjes së ofertave, vetë AK-ja kishte sqaruar se qëllimi i pajisjes ishte **pastrimi i xhamave dhe sipërfaqeve në lartësi**. Ky sqarim e ka përcaktuar përmbajtjen funksionale të kriterit dhe ka krijuar pritje të ligjshme se pajisjet do të vlerësoheshin sipas aftësisë për ta realizuar këtë funksion.

AK-ja nuk mund të japë para hapjes një interpretim funksional dhe, pasi t'i njohë ofertuesit, dokumentet dhe çmimet, ta zëvendësojë atë me një interpretim formal dhe më kufizues.

Një veprim i tillë përbën:

- ndryshim të standardit të vlerësimit pas hapjes së ofertave;
- përdorim të një kriteri të papublikuar;
- cenim të parashikueshmërisë së procedurës;
- shkelje të sigurisë juridike;
- dhe trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë.

Dokumentacioni i Ankuesit përmban të dhëna për pajisjen, modelin, pronarin, kapacitetin, shtrirjen, marrëveshjen e disponueshmërisë dhe përdorimin e saj për punë në lartësi. Përballë këtyre provave, AK-ja ishte e detyruar ose:

1. të konstatonte, përmes një analize profesionale, parametrin konkret që nuk përmbushej; ose
2. të kërkonte sqarimin e dokumentacionit ekzistues, pa lejuar ndryshim material të ofertës.

AK-ja nuk e ka bërë as njërën dhe as tjetrën. Ajo ka zgjedhur eliminimin automatik, pa ekspertizë, pa analizë krahasuese dhe pa përcaktimin e ndikimit material të mospërputhjes së pretenduar.

Kjo qasje është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 59.4 të LPP-së. Edhe nëse dallimi në emërtim do të konsiderohej paqartësi ose devijim, AK-ja duhej të përcaktonte nëse ai:

- ndryshon ndonjë kusht material të tenderit;
- cenon realizimin e kontratës;
- kufizon të drejtat e AK-së;
- zvogëlon obligimet e Ankuesit;
- ose krijon avantazh të padrejtë konkurrues.

Vendimi i kundërshtuar nuk identifikon asnjë pasojë të tillë. OSHP-ja nuk duhet ta lejojë që mungesa e analizës së AK-së të plotësohet pas paraqitjes së ankesës me arsyetime të reja. Ligjshmëria e vendimit duhet të vlerësohet sipas fakteve, provave dhe arsyetimit të përfshirë në vendim në momentin e nxjerrjes së tij.

Nëse OSHP-ja do ta pranonte këtë mënyrë vlerësimi, do të krijohet një precedent i rrezikshëm, sipas të cilit AK-ja mund:

- të publikojë një kriter funksional;
- ta sqarojë atë para hapjes;
- ta ndryshojë kuptimin pas hapjes;
- të krijojë një kusht të ri eliminues;
- dhe ta refuzojë ofertën më të lirë pa ekspertizë teknike.

Një standard i tillë do ta cenonte rëndë barazinë, transparencën, konkurrencën dhe sigurinë juridike në prokurimin publik. Për këtë arsye, kërkohet që eksperti shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues të mos mjaftohen me përsëritjen e formulimit të AK-së, por të përcaktojnë konkretisht:

1. cili parametër teknik i publikuar nuk është përmbushur;
2. me cilën provë vërtetohet mospërmbushja;
3. si është trajtuar sqarimi i AK-së para hapjes;
4. pse dokumentacioni ekzistues nuk mund të sqarohet sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së;
5. në çfarë mënyre dallimi në emërtim është material;
6. dhe nëse i njëjti standard është zbatuar ndaj SELMANS NETWORK SH.P.K.

Pa përgjigje të argumentuar për secilën nga këto çështje, çdo rekomandim për refuzimin e ankesës do të ishte i paplotë, i pambështetur në prova dhe në kundërshtim me detyrimin për shqyrtim objektiv dhe efektiv.

Në përfundim, AK-ja nuk ka vërtetuar papërshtatshmërinë teknike të pajisjes; ajo vetëm e ka prezumuar atë. Në procedurën e prokurimit publik, tenderi nuk mund të eliminohet mbi bazën e një prezumimi, veçanërisht kur:

- qëllimi funksional është sqaruar nga vetë AK-ja;
- pajisja është deklaruar brenda afatit;
- dokumentacioni teknik është dorëzuar;
- dhe AK-ja nuk ka paraqitur asnjë analizë profesionale që i rrëzon këto prova.

Për rrjedhojë, eliminimi i Ankuesit është në kundërshtim me standardet e praktikës së OSHP-së dhe me nenet 7, 56.3, 59.2, 59.4, 69, 72 dhe 108/A të LPP-së. Ai duhet të konstatohet i pabazuar, ndërsa vendimi për anulimin e aktivitetit duhet të shfuqizohet.

14. Kërkesë për ekspertizë teknike të pavarur

Për shkak se AK-ja ka nxjerrë përfundime teknike pa ekspertizë profesionale, kërkohet që eksperti shqyrtues dhe,

sipas nevojës, Paneli Shqyrtues:

- ta shqyrtojnë dokumentacionin e plotë teknik;
- ta krahasojnë pajisjen me qëllimin funksional të sqaruar nga AK-ja;
- ta analizojnë shtrirjen e krahut teleskopik dhe shtojcës Jib;
- t'i shqyrtojnë fotografitë dhe dokumentet identifikuese;
- dhe të përcaktojnë nëse AK-ja kishte bazë profesionale për eliminim.

Nëse nevojitet njohuri e specializuar, duhet të caktohet ekspert teknik i fushës së makinerisë. Një çështje teknike nuk mund të vendoset përfundimisht nga komisioni vetëm përmes krahasimit gjuhësor të dy emërtimeve.

15. Përfundim për këtë shkelje

Eliminimi i Ankuesit për pajisjen është në kundërshtim me:

- nenin 7 të LPP-së;
- nenin 28 të LPP-së;
- nenin 52.3 të LPP-së;
- nenin 56.1.1 dhe 56.3 të LPP-së;
- nenin 59.2 dhe 59.4 të LPP-së;
- nenin 69 të LPP-së;
- nenin 72 të LPP-së;
- nenin 108/A të LPP-së;
- sqarimin zyrtar të AK-së para hapjes së tenderëve;
- dhe parimet e vendosura në praktikën e OSHP-së.

AK-ja ka ndryshuar pas hapjes kuptimin e kriterit, ka shpërfillur sqarimin e vet, ka përdorur një kusht të papublikuar, ka refuzuar provat pa analizë teknike dhe ka zbatuar standard të ndryshëm ndaj operatorëve.

Ky nuk është ushtrim i ligjshëm i diskrecionit. Është vlerësim arbitrar me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin e procedurës.

Për pasojë, arsyerja e eliminimit lidhur me Aneksin 7 duhet të shpallet e pabazuar dhe e kundërligjshme. Me rënien e kësaj arsyeje dhe të arsyes lidhur me vlefshmërinë prej 365 ditësh, bie edhe premisa se “asnjëri prej tenderëve nuk është i përgjegjshëm” dhe, rrjedhimisht, bie baza juridike për anulimin e procedurës sipas nenit 43.5(b) të Rregullores Nr. 001/2022.

C. Shkelja e parimit të economicitetit dhe shmangia e kriterit për dhënien e kontratës

Oferta e GOE Ankues ishte në vlerë prej **174,084.00 euro**, ndërsa oferta e OE SELMANS NETWORK SH.P.K. ishte **208,900.80 euro**. Diferenca është: $208,900.80 - 174,084.00 = 34,816.80$ euro $208,900.80 - 174,084.00 = 34,816.80$ euro

Pra, oferta e Ankuesit siguron një kursim të drejtpërdrejtë prej **34,816.80 euro** për buxhetin publik.

1. Shkelja e neneve 1 dhe 6 të LPP-së

Sipas **nenit 1.1 të LPP-së**, qëllimi i ligjit është sigurimi i mënyrës më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Sipas **nenit 6.1 të LPP-së**, të gjitha autoritetet kontraktuese janë të detyruara të sigurojnë që fondet dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

AK-ja nuk mund të thirret në diskrecion administrativ për të anuluar një procedurë kur ky diskrecion mbështetet mbi eliminimin e paligjshëm të tenderit me çmimin më të ulët.

Ekonomiciteti nuk mund të përdoret për të pranuar një ofertë të papërgjegjshme, por as formalizmi nuk mund të përdoret për ta shpallur të papërgjegjshme një ofertë materialisht të rregullt dhe për t'ia mohuar buxhetit publik kursimin prej 34,816.80 euro.

2. Shkelja e nenit 60.1.1 të LPP-së

Kriteri i përcaktuar në këtë aktivitet ishte tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Neni 60.1.1 i LPP-së përcakton se AK-ja ia jep kontratën operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Pas eliminimit të ligjshëm të SELMANS NETWORK SH.P.K., AK-ja ishte e detyruar ta vlerësonte ofertën e Ankuesit në mënyrë përmbajtjesore dhe të paanshme. Ajo nuk kishte të drejtë të krijonte arsye formale dhe kriterë të papublikuara për ta shpallur edhe këtë ofertë të papërgjegjshme dhe më pas ta përdorte vetë këtë eliminim si bazë për anulim.

3. Anulimi sipas nenit 43.5(b) nuk ka bazë faktike

Autoriteti Kontraktues e ka mbështetur anulimin e aktivitetit në **nenin 43.5(b) të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, sipas të cilit procedura pas hapjes së ofertave anulohet kur:

“Asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm.”

Zbatimi i kësaj dispozite nuk varet nga vullneti i lirë apo diskrecioni i pakufizuar i AK-së. Ajo mund të zbatohet vetëm pasi, përmes një procesi të ligjshëm, objektiv dhe të dokumentuar, të jetë vërtetuar se secila ofertë e pranuar është materialisht e papërgjegjshme.

Pra, para anulimit, AK-ja ishte e detyruar të dëshmonte në mënyrë kumulative se:

1. të gjitha ofertat janë ekzaminuar sipas kërkesave të publikuara;
2. ndaj të gjithë operatorëve është zbatuar i njëjti standard;

3. dokumentet dhe provat janë shqyrtuar në tërësi;
4. çdo paqartësi e sqarueshme është trajtuar sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së;
5. mospërputhjet e konstatuara kanë qenë reale dhe materialisht eliminuese;
6. dhe për secilën ofertë është dhënë arsyetim i individualizuar faktik dhe juridik.

Asnjëri prej këtyre kushteve nuk është përmbushur në raport me ofertën e Ankuesit.

Premisa mbi të cilën është mbështetur anulimi është e gabuar

Konstatimi se “asnjëri prej tenderëve nuk është i përgjegjshëm” nuk është fakt objektiv që ka ekzistuar pavarësisht veprimeve të AK-së. Ai është rezultat i drejtpërdrejtë i eliminimit të kundërligjshëm të Ankuesit për dy arsye të pambështetura:

- deklarimin e vlefshmërisë prej 365 ditësh, e cila e përfshin dhe e tejkalon periudhën minimale prej 90 ditësh; dhe
- paraqitjen e një pajisjeje të deklaruar dhe dokumentuar, të cilën AK-ja e ka refuzuar mbi bazën e emërimit formal, pa analizuar funksionin, karakteristikat teknike dhe sqarimin e vet para hapjes së ofertave.

Këto arsye nuk e bëjnë tenderin materialisht të papërgjegjshëm. Ato janë rezultat i interpretimit formalist dhe i përdorimit të standardeve që nuk janë përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit.

AK-ja ka krijuar vetë gjendjen faktike mbi të cilën është thirrur për anulim

AK-ja nuk mund:

1. ta eliminojë në mënyrë të kundërligjshme tenderin e Ankuesit;
2. të krijojë vetë situatën sikur në procedurë nuk ekziston asnjë tender i përgjegjshëm;
3. dhe pastaj ta përdorë këtë situatë, të prodhuar nga vetë shkelja e saj, si bazë për anulimin e procedurës.

Një arsyetim i tillë është rrethor dhe juridikisht i papranueshëm. AK-ja po përpiqet ta justifikojë anulimin përmes pasojës së një eliminimi, ligjshmërinë e të cilit nuk e ka provuar. Autoriteti publik nuk mund të krijojë përmes veprimeve të veta të kundërligjshme kushtet për zbatimin e një dispozite dhe më pas të përfitojë juridikisht nga gjendja që vetë e ka shkaktuar.

Anulimi është përdorur si zëvendësim për rivlerësimin e ligjshëm

Pas kërkesës së parë për rishqyrtim, AK-ja e pranoi se oferta e OE SELMANS NETWORK SH.P.K. përmbante gabim financiar mbi kufirin e lejuar dhe e ktheu aktivitetin në rivlerësim.

Në atë moment, AK-ja ishte e detyruar:

- t'i trajtonte të gjitha pretendimet e Ankuesit;
- ta rivlerësonte ofertën e tij sipas përmbajtjes së dokumenteve;
- ta merrte parasysh vlefshmërinë më të gjatë;
- ta zbatonte sqarimin për qëllimin funksional të pajisjes;
- dhe ta zbatonte kriterin "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

Në vend të kësaj, sapo u konfirmua se operatori i rekomanduar fillimisht nuk mund të shpallej fitues, AK-ja anuloi tërë procedurën. **Kjo kronologji krijon dyshim objektiv dhe serioz se neni 43.5(b) nuk është përdorur si pasojë e një vlerësimi të ligjshëm të të gjitha ofertave, por si instrument për ta shmangur rezultatin që do të prodhonte një rivlerësim real dhe përmbajtjesor.**

Mosshqyrtimi i pretendimeve të para e bën anulimin edhe më të paqëndrueshëm

Në Vendimin e datës 11.08.2026, AK-ja nuk u ishte përgjigjur pretendimeve që kundërshtonin eliminimin e Ankuesit. Ajo trajtoi vetëm gabimet e SELMANS NETWORK SH.P.K. dhe e ktheu aktivitetin në rivlerësim. Më pas, në vendimin e datës 25.08.2026, AK-ja e përdori si bazë për anulim pikërisht eliminimin e Ankuesit, për të cilin më parë nuk kishte dhënë vendim të plotë dhe të arsyetuar.

AK-ja nuk mund ta trajtojë si çështje përfundimisht të vendosur një pretendim të cilin nuk e ka shqyrtuar fare. Mosvendosja sipas nenit 108/A të LPP-së nuk mund të prodhojë efekt juridik në dëm të Ankuesit.

Për këtë arsye, anulimi është ndërtuar mbi një procedurë paraprake të cenuar nga shkelje esenciale.

Neni 43.5(b) nuk mund të interpretohet i izoluar nga LPP-ja

Dispozita për anulimin duhet të zbatohet në harmoni me:

- **nenin 1 të LPP-së**, për përdorim efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike;
- **nenin 6**, për ekonomikitetin dhe efikasitetin;
- **nenin 7**, për trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe transparencën;
- **nenin 56.3**, që ndalon eliminimin mbi kriteret të papublikuara;
- **nenin 59**, për ekzaminimin objektiv dhe material të tenderëve;
- dhe **nenin 60.1.1**, sipas të cilit kontrata i jepet tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

AK-ja nuk mund ta përdorë nenin 43.5(b) për t'i anashkaluar këto detyrime. Anulimi nuk është alternativë ndaj vlerësimit të ligjshëm dhe as mekanizëm për t'iu shmangur nenit 60.1.1 të LPP-së.

Anulimi cenon drejtpërdrejt ekonomikitetin e fondeve publike

Oferta e Ankuesit është në vlerë prej **174,084.00 euro**, ndërsa oferta e SELMANS NETWORK SH.P.K. ishte **208,900.80 euro**. Diferenca prej **34,816.80 euro** është pasojë financiare konkrete dhe e matshme.

Kjo diferencë nuk mund ta bëjë një tender automatikisht të përgjegjshëm, por bëhet vendimtare pasi arsyet e

eliminimit të Ankuesit rezultojnë të pabazuara. Në atë rast, nenet 6 dhe 60.1.1 të LPP-së e detyrojnë AK-në ta mbrojë interesin publik dhe ta zbatojë kriterin e publikuar për dhënien e kontratës.

Anulimi i procedurës:

- e humb kursimin prej 34,816.80 euro;
- krijon shpenzime të reja administrative;
- e vonon ofrimin e shërbimeve të pastrimit;
- dhe e ekspozon Komunën ndaj çmimeve potencialisht më të larta në një procedurë të re.

Barra për të provuar kushtet e anulimit i takon AK-së

Meqenëse AK-ja e ka nxjerrë vendimin për anulim, asaj i takon barra të provojë se kushtet e nenit 43.5(b) janë plotësuar.

AK-ja duhet të dëshmojë:

- se oferta e Ankuesit është vlerësuar sipas kriterëve të publikuara;
- se është analizuar dokumentacioni teknik;
- se është marrë parasysh sqarimi para hapjes;
- se vlefshmëria prej 365 ditësh paraqet devijim material;
- se mospërputhjet nuk kanë qenë të sqarueshme;
- dhe se ndaj të dy operatorëve është zbatuar standard i njëjtë.

Vendimet e kundërshtuara nuk përmbajnë një provë të tillë. OSHP-ja nuk duhet ta plotësojë në vend të AK-së arsyetimin që mungon dhe as të kërkojë pas paraqitjes së ankesës arsye të reja për ta mbajtur në fuqi anulimin.

Anulimi sipas nenit 43.5(b) është juridikisht i qëndrueshëm vetëm nëse përgjegjëshmëria e të gjithë tenderëve është konstatuar në mënyrë të ligjshme.

Në këtë rast, përgjegjëshmëria e ofertës së Ankuesit:

- nuk është provuar teknikisht;
- mbështetet në kriter të papublikuar;
- buron nga interpretimi i gabuar i vlefshmërisë;
- bie ndesh me sqarimin e AK-së para hapjes;
- dhe është konstatuar pa shqyrtim të plotë të provave.

Prandaj, premisa faktike e nenit 43.5(b) nuk ekziston.

Me rënien e arsyeve të eliminimit të Ankuesit, bie automatikisht edhe konstatimi se “asnjëri prej tenderëve nuk është i përgjegjshëm”. Me rënien e këtij konstatimi, vendimi për anulim mbetet pa bazë faktike dhe juridike.

4. Pasojat konkrete të anulimit

Anulimi i procedurës:

- e ekspozon buxhetin komunal ndaj një shpenzimi potencialisht më të lartë;
- e humb mundësinë e kursimit prej 34,816.80 euro;
- e vonon sigurimin e shërbimeve të pastrimit;
- cenon vazhdimësinë e higjienës në institucionet e kujdesit shëndetësor;
- krijon shpenzime të reja administrative;
- dhe e detyron AK-në të zhvillojë procedurë të re pa ekzistuar nevoja ligjore për anulim.

Rrjedha e veprimeve të AK-së krijon dyshim objektiv dhe serioz se anulimi është përdorur për të shmangur rezultatin që do të prodhonte një rivlerësim i ligjshëm: konstatimin se Ankuesi ka paraqitur tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

16. Veprimet e AK-së përbëjnë arbitraritet administrativ dhe zbatim selektiv të ligjit

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një dallim të zakonshëm profesional ndërmjet AK-së dhe Ankuesit. Kemi të bëjmë me një varg veprimesh dhe mosveprimesh që, të vlerësuara së bashku, tregojnë shmangie serioze nga ligjshmëria:

- AK-ja e ka sqaruar para hapjes së tenderëve se pajisja kërkohej për pastrimin e xhamave në lartësi;
- Ankuesi ka dorëzuar pajisje që, sipas dokumentacionit, arrin lartësinë e kërkuar dhe realizon funksionin e sqaruar;
- AK-ja e ka shpërfillur sqarimin e vet;
- ka përdorur emërtimin në librezë si kriter eliminues, ndonëse një kriter i tillë nuk ishte publikuar;
- nuk ka kryer ekspertizë teknike;
- nuk ka identifikuar parametrin konkret të papërmbyshur;
- nuk i ka shqyrtuar provat në tërësi;
- dhe nuk u është përgjigjur pretendimeve vendimtare të Ankuesit.

Një vendimmarrje e tillë nuk mund të mbrohet me “diskrecionin” e Autoritetit Kontraktues. Diskrecioni administrativ nuk është autorizim për arbitraritet, nuk e lejon ndryshimin e kriterëve pas hapjes së ofertave dhe nuk e përjashton AK-në nga detyrimi për të provuar dhe arsyetuar çdo shkak eliminimi.

Kur një vendim:

- bie ndesh me sqarimin e vetë organit;
- nuk mbështetet në analizë teknike;
- nuk i shqyrton provat;
- përdor kritere të papublikuara;

- dhe prodhon eliminimin e ofertës për 34,816.80 euro më të lirë,

atëherë nuk kemi më një vlerësim të ligjshëm, por **arbitraritet administrativ me pasoja konkrete financiare**.

17. Shkelja e neneve 7.1, 7.2 dhe 7.3 të LPP-së – trajtim i pabarabartë dhe cenim i konkurrencës

Sipas nenit 7.1 të LPP-së, AK-ja është e detyruar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, jodiskriminuese dhe transparente.

Sipas nenit 7.2, AK-ja nuk mund të zhvillojë asnjë aspekt të aktivitetit në mënyrë që redukton konkurrencën apo diskriminon në dëm ose në favor të një operatori ekonomik.

Sipas nenit 7.3, AK-së i ndalohet përdorimi i kërkesave ose specifikimeve teknike që kanë efekt favorizues apo diskriminues.

Në rastin konkret, standardi i vlerësimit nuk është zbatuar njësoj:

- ndaj Ankuesit është përdorur interpretimi më formalist dhe më kufizues;
- dokumentacioni teknik i Ankuesit është shpërfillur;
- një emërtim administrativ është shndërruar në kriter absolut eliminues;
- ndërsa paqartësitë në dokumentacionin e operatorit tjetër janë trajtuar me standard dukshëm më tolerant.

Barazia nuk nënkupton vetëm që dokumentet e operatorëve të lexohen nga i njëjti komision. Barazia kërkon që të njëjtat rregulla, të njëjtat metoda verifikimi dhe i njëjti nivel rigoroziteti të zbatohen ndaj secilit operator.

AK-ja nuk mund:

- ndaj një operatori ta vlerësojë funksionin e pajisjes;
- ndërsa ndaj operatorit tjetër vetëm emërtimin në librezë;
- ndaj njërit të pranojë dokumentacion që kërkon verifikim;
- ndërsa ndaj tjetrit të refuzojë edhe dokumentacionin teknik ekzistues;
- dhe pastaj të pretendojë se ka respektuar nenin 7 të LPP-së.

Ky është standard i dyfishtë dhe efektivisht diskriminues.

18. Shkelja e neneve 28, 52.3 dhe 56.3 të LPP-së – ndalimi i kriterëve të papublikuara

Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar Ankuesin duke përdorur një kusht që nuk është përcaktuar as në Njoftimin për Kontratë, as në Dosjen e Tenderit dhe as në sqarimet e publikuara para hapjes së ofertave.

Ky veprim përbën shkelje të drejtpërdrejtë të neneve **28, 52.3 dhe 56.3 të LPP-së** dhe nuk mund të arsyetohet si ushtrim i diskrecionit teknik të Komisionit Vlerësues.

Vlerësimi mund të mbështetet vetëm në kriteret e publikuara paraprakisht

Sipas nenit 52.3 të LPP-së, gjatë vlerësimit mund të përdoren vetëm kriteret e matshme dhe të përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit.

Sipas nenit 56.3 të LPP-së:

Tenderuesi nuk mund të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura mbi bazën e ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Kjo dispozitë ka karakter detyrues. Ajo nuk i lë AK-së hapësirë që pas hapjes së ofertave të plotësojë, zgjerojë apo ndryshojë përmbajtjen e kriterëve. Qëllimi i kësaj ndalese është që çdo operator ekonomik, para dorëzimit të ofertës, të jetë në gjendje të dijë saktësisht:

- çfarë kërkohet;
- si duhet të dëshmohet kërkesa;
- sipas cilave karakteristika do të bëhet vlerësimi;
- dhe cilat mangësi mund të shkaktojnë eliminim.

Operatori ekonomik nuk mund të eliminohet për mosplotësimin e një kushti për të cilin nuk ka qenë i informuar paraprakisht.

Dosja nuk ka kërkuar një emërtim të posaçëm në librezë

Në këtë aktivitet nuk është përcaktuar që:

- në librezën e regjistrimit duhet të figurojë shprehimisht termi “kamion me korpë”;
- pajisja duhet të ketë një emërtim të caktuar administrativ;
- emërtimi në librezë përbën specifikim teknik të pavarur;
- pajisja duhet të jetë e një marke, modeli ose prodhuesi të caktuar;
- pajisja duhet të ketë vetëm një konfigurim të veçantë teknik;
- mekanizmi ngritës duhet të emërtohet në një mënyrë të caktuar;
- ose ndalohet përdorimi i një automjeti special me mekanizëm ngritës që realizon funksionin e kërkuar.

Mënyra e dëshmimit përmes librezës valide ka pasur për qëllim identifikimin, regjistrimin dhe vlefshmërinë e automjetit. Ajo nuk e ka shndërruar emërtimin administrativ të mjetit në specifikim të veçantë teknik.

AK-ja po i ngatërron dy çështje juridikisht të ndryshme:

1. dokumentin përmes të cilit dëshmohet pajisja; dhe
2. karakteristikat teknike që pajisja duhet të përmbushë.

Kërkesa për “librezë valide” nuk nënkupton automatikisht kërkesë që në librezë të figurojë fjalë për fjalë emërtimi i përdorur në Aneksin 7. **Nëse AK-ja kishte synuar që emërtimi në librezë të ishte kusht absolut dhe eliminues,**

ajo duhej ta përcaktonte këtë në mënyrë të qartë, shprehimore dhe pa ekuivok para dorëzimit të ofertave.

Sqarimi para hapjes e përjashton interpretimin formal të përdorur nga AK-ja

Para hapjes së tenderëve, pas pyetjes së një operatori ekonomik, AK-ja kishte sqaruar se pajisja kërkohej për **pastrimin e xhamave dhe sipërfaqeve në lartësi.**

Ky sqarim tregon se kërkesa kishte qëllim funksional: sigurimin e kapacitetit për kryerjen e shërbimit në lartësi.

AK-ja nuk kishte deklaruar në përgjigjen e saj se:

- rëndësi vendimtare ka vetëm emërtimi në librezë;
- nuk pranohen pajisje me emërtim tjetër administrativ;
- ose një automjet special me mekanizëm ngritës do të refuzohet pavarësisht funksionit dhe parametrave teknikë.

Përkundrazi, përmes sqarimit, AK-ja i kishte orientuar operatorët drejt funksionit të pajisjes. Pas hapjes, AK-ja nuk mund ta zëvendësojë kriterin funksional me një kusht formal që nuk ishte komunikuar paraprakisht.

AK-ja ka krijuar pas hapjes një shkak të ri eliminimi

Në vendimin e kundërshtuar, emërtimi në librezë është trajtuar si kusht absolut për përgjegjshmërinë e tenderit.

Ky kusht është krijuar vetëm gjatë vlerësimit, pasi AK-ja kishte njohuri për:

- identitetin e tenderuesve;
- pajisjet e paraqitura;
- dokumentacionin teknik;
- dhe çmimet e ofertave.

Vendosja e një kushti të ri në këtë fazë cenon barazinë dhe parashikueshmërinë e procedurës. Operatorët nuk kanë pasur mundësi ta marrin parasysh këtë kusht gjatë përgatitjes së tenderëve, sepse ai nuk ka ekzistuar në dokumentet e procedurës. AK-ja nuk mund të kërkojë pas hapjes atë që nuk e ka kërkuar para hapjes dhe nuk mund ta ndëshkojë operatorin për mospërbushjen e një standardi të krijuar vetëm gjatë vlerësimit.

Kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e nenit 56.3 të LPP-së, jo thjesht mosmarrëveshje mbi interpretimin teknik.

Interpretimi nuk mund të ndryshojë përmbajtjen e kriterit

AK-ja mund të interpretojë një kërkesë vetëm brenda kufijve të tekstit të publikuar, qëllimit të saj dhe sqarimeve të dhëna para hapjes.

Interpretimi nuk mund:

- të shtojë elemente të reja;
- të zgjerojë bazat për eliminim;
- të ndryshojë mënyrën e dëshmimit;
- të krijojë një standard të ri teknik;
- ose ta shndërrojë një emërtim përshkrues në kusht absolut administrativ.

Në këtë rast, AK-ja nuk e ka interpretuar kriterin ekzistues. Ajo e ka ndryshuar atë.

Kriteri i publikuar lidhej me pajisjen dhe lartësinë e nevojshme për realizimin e shërbimit. Kriteri i zbatuar gjatë vlerësimit lidhej me formulimin tekstual që duhej të figuronte në librezë. Këto nuk janë i njëjti kriter.

Paqartësia e Dosjes nuk mund të përdoret kundër tenderuesit

Nëse AK-ja konsideron se shprehja “kamion me korpë” ka nënkuptuar domosdoshmërisht:

- një klasifikim të veçantë në librezë;
- platformë të një lloji të caktuar;
- mekanizëm të posaçëm;
- certifikim të veçantë;
- ose një konfigurim teknik të vetëm,

atëherë këto elemente duhej të përcaktoheshin qartë në Dosjen e Tenderit. Mungesa e përcaktimit nuk mund të korrigjohet pas hapjes në dëm të operatorit ekonomik. AK-ja është hartuese e Dosjes dhe mban përgjegjësinë për qartësinë e kërkesave. **Ajo nuk mund të përfitojë juridikisht nga paqartësia e formulimit të vet dhe as ta interpretojë atë në mënyrën më kufizuese për tenderuesin.**

Cenimi i nenit 28 të LPP-së

Sipas nenit 28 të LPP-së, specifikimet teknike duhet të lidhen me qëllimin e prokurimit, të jenë të qarta dhe të sigurojnë qasje të barabartë për operatorët ekonomikë. Në këtë procedurë, qëllimi funksional ishte pastrimi i xhamave në lartësi. Prandaj, vlerësimi duhej të analizonte nëse pajisja e deklaruar:

- arrin lartësinë e kërkuar;
- mundëson qasjen në sipërfaqet përkatëse;
- posedon mekanizmin e nevojshëm;
- dhe mund ta realizojë shërbimin në mënyrë të sigurt.

AK-ja nuk e ka kryer këtë analizë. Ajo e ka zëvendësuar vlerësimin teknik me krahasimin e dy emërtimeve. Në këtë mënyrë, një kërkesë funksionale është shndërruar në kufizim formal që nuk ka qenë i publikuar.

Cenimi i barazisë dhe konkurrencës sipas nenit 7 të LPP-së

Përdorimi i një kriteri të papublikuar nuk është shkelje vetëm e nenit 56.3. Ai cenon drejtpërdrejt edhe nenin 7 të LPP-së.

Operatorët ekonomikë mund të trajtohen në mënyrë të barabartë vetëm nëse:

- **kriteret njihen paraprakisht;**
- **nuk ndryshojnë gjatë vlerësimit;**
- **dhe zbatohen me të njëjtin kuptim ndaj të gjithë tenderuesve.**

Një standard i krijuar pas hapjes krijon mundësi për zbatim selektiv. Pikërisht për këtë arsye LPP-ja e ndalon në mënyrë kategorike eliminimin mbi kritere të papublikuara. AK-ja nuk mund të zbatojë ndaj Ankuesit standardin më kufizues të mundshëm dhe ndaj operatorit tjetër standard funksional ose më tolerant.

Kriteri i papublikuar ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultat

Shkelja ka pasur ndikim vendimtar. Nëse emërtimi në librezë nuk do të ishte përdorur si kriter i ri eliminues:

- oferta e Ankuesit do të duhej të vlerësohej sipas funksionit dhe parametrave teknikë;
- do të duhej të merrej parasysh sqarimi para hapjes;
- çdo paqartësi do të mund të sqarohet pa ndryshuar ofertën;
- dhe nuk do të ekzistonte baza për konstatimin se asnjëri nga tenderët nuk ishte i përgjegjshëm.

Pra, kriteri i papublikuar nuk ka prodhuar vetëm eliminimin e Ankuesit. Ai është përdorur edhe për krijimin artificial të kushteve për anulimin e tërë aktivitetit sipas nenit 43.5(b) të Rregullores. Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar Ankuesin për mospërmbylljen e një kriteri të publikuar. E ka eliminuar për mospërmbylljen e një kushti që AK-ja e ka formuluar vetëm pas hapjes së ofertave.

Kjo përbën:

- përdorim të kriterit të papublikuar;
- ndryshim të rregullave gjatë procedurës;
- tejkalim të kompetencës vlerësuese;
- cenim të trajtimit të barabartë;
- cenim të konkurrencës efektive;
- dhe shkelje esenciale me ndikim vendimtar në rezultat.

Çdo përpjekje e AK-së për ta paraqitur këtë kusht të ri si “interpretim” duhet të refuzohet. Interpretimi mund ta qartësojë një kriter, por nuk mund ta zgjerojë atë, ta ndryshojë përmbajtjen ose të krijojë shkak të ri eliminimi. Për pasojë, eliminimi i Ankuesit është në kundërshtim me nenet **7, 28, 52.3 dhe 56.3 të LPP-së** dhe duhet të shpallet i papabazuar. Me anulimin e kësaj arsyeje eliminuese bie edhe baza faktike për anulimin e procedurës sipas nenit

43.5(b) të Rregullores Nr. 001/2022.

19. Shkelja e nenit 59 të LPP-së – mungesa e ekzaminimit real dhe profesional

Neni 59 i LPP-së nuk e autorizon komisionin që vetëm t'i regjistrojë dokumentet dhe të nxjerrë përfundime deklarative. Ai kërkon ekzaminim, vlerësim dhe krahasim real të tenderëve.

Në këtë rast nuk ka pasur ekzaminim përmbajtjesor sepse AK-ja nuk ka analizuar:

- shtrirjen e krahut prej 50 metrash;
- shtojcën Jib prej 17 metrash;
- lartësinë maksimale operative;
- fotografitë e pajisjes;
- qëllimin e deklaruar të përdorimit;
- marrëveshjen e disponueshmërisë;
- dhe raportin teknik për karakteristikat e pajisjes.

AK-ja ka nxjerrë përfundim teknik pa analizë teknike. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 59 dhe përbën konstatim të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike. OSHP-ja nuk duhet ta pranojë si “vlerësim profesional” një përfundim që nuk identifikon as faktin teknik vendimtar mbi të cilin mbështetet.

20. Shkelja e nenit 59.4 të LPP-së – mungesa e testit të materialitetit

Edhe sikur të supozohej se ekziston dallim ndërmjet emërimit të pajisjes së kërkuar dhe atij në librezë, kjo nuk mjafton për eliminim.

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, AK-ja duhet të përcaktojë nëse dallimi:

- ndryshon një kusht material;
- ndikon në karakteristikat thelbësore;
- kufizon të drejtat e AK-së;
- zvogëlon obligimet e operatorit;
- apo krijon avantazh të padrejtë.

AK-ja nuk ka kryer asnjë test të tillë.

Në vendimin e saj mungon përgjigjja se si emërtimi “automjet special me vinç” e pengon realizimin e pastrimit të xhamave, kur dokumentacioni tregon kapacitet për punë në lartësi.

Eliminimi pa test të materialitetit është automatik, mekanik dhe i kundërligjshëm.

21. Shkelja e neneve 59.2, 69 dhe 72 të LPP-së – mosqartësimi i dokumentacionit teknik

AK-ja nuk mund të pretendojë njëkohësisht se:

- pajisja ishte e deklaruar dhe dokumentuar;
- dokumentacioni nuk ishte mjaftueshëm i qartë;
- dhe sqarimi do të përbënte ndryshim material.

Këto përfundime janë kundërtënëse.

Pajisja DEMAG AC205 ishte pjesë e ofertës fillestare. Identiteti, pronari, modeli, të dhënat teknike dhe marrëveshja e disponueshmërisë ishin paraqitur brenda afatit.

Sqarimi i funksionit të së njëjtës pajisje nuk do të krijonte kapacitet të ri. Prandaj, nenet 59.2 dhe 72 të LPP-së lejonin verifikimin dhe qartësimin e dokumentacionit ekzistues.

Refuzimi për ta qartësuar një paqartësi të sqarueshme, e më pas përdorimi i së njëjtës paqartësi si arsye eliminuese, përbën formalizëm të pajustificueshëm dhe keqpërdorim të procesit të vlerësimit.

22. Shkelja e nenit 108/A të LPP-së – vendim pa arsyetim efektiv

Vendimi i AK-së nuk është i arsyetuar vetëm pse përmban disa paragrafë tekst.

Arsyetimi juridik kërkon:

- përcaktimin e fakteve;
- administrimin e provave;
- vlerësimin e secilës provë;
- zbatimin e dispozitës ligjore mbi faktet;
- dhe nxjerrjen e përfundimit logjik.

Në vendimin e datës 04.09.2026 mungon lidhja ndërmjet provave dhe përfundimit.

AK-ja deklaron se pajisja nuk përputhet, por nuk tregon:

- provën teknike që e mbështet këtë;
- parametrin që mungon;
- arsyen pse funksioni nuk realizohet;
- arsyen pse sqarimi i vet para hapjes nuk është relevant;
- dhe arsyen pse dokumentacioni i Ankuesit refuzohet.

Vendimi që vetëm përsërit kriterin dhe shpall mospërmbushjen e tij nuk është vendim i arsyetuar në kuptim të nenit 108/A.

23. Indicie objektive për rivlerësim formal dhe rezultat të orientuar

Ankuesi nuk pretendon pa prova ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje të paligjshme. Megjithatë, rrethanat objektive kërkojnë shqyrtim veçanërisht rigoroz nga OSHP-ja:

1. Fillimisht është rekomanduar operatori me ofertë 34,816.80 euro më të shtrenjtë;
2. Oferta e tij përmbante gabim financiar mbi kufirin prej 2%;
3. AK-ja e pranoi kërkesën e Ankuesit dhe e ktheu lëndën në rivlerësim;
4. AK-ja nuk u përgjigj ndaj pretendimeve që kundërshtonin eliminimin e Ankuesit;
5. Pasi operatori i rekomanduar nuk mund të shpallej më fitues, AK-ja anuloi tërë procedurën;
6. Si bazë për anulim përdori të njëjtat arsye ndaj të cilave më parë nuk kishte dhënë përgjigje;
7. Në vlerësimin e pajisjes së Ankuesit shpërfilli sqarimin e vet para hapjes;
8. Dhe aplikoi një kriter formal që nuk ishte përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Kjo kronologji krijon dyshim objektiv se rivlerësimi nuk është kryer për të korrigjuar shkeljet, por për ta ruajtur rezultatin praktik të eliminimit të Ankuesit.

OSHP-ja nuk duhet ta trajtojë secilin gabim të izoluar. Ajo duhet ta vlerësojë efektin kumulativ të tyre dhe ndikimin vendimtar që kanë pasur në rezultatin e procedurës.

24. Paralajmërim formal për përgjegjësinë institucionale dhe pasojat juridike

Ankuesi kërkon nga OSHP-ja që t'i shqyrtojë plotësisht këto shkelje dhe të mos lejojë që anulimi të përdoret si mekanizëm për mbulimin e një rivlerësimi të kundërligjshëm. Nëse vendimet e AK-së mbeten në fuqi pavarësisht provave dhe shkeljeve të dokumentuara, Ankuesi rezervon të drejtën që:

- të përdorë të gjitha mjetet juridike të lejuara;
- të iniciojë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente;
- të kërkojë kompensimin e dëmit dhe fitimit të humbur;
- të kërkojë shqyrtimin e përgjegjësisë së personave të përfshirë;
- t'i drejtohet KRPP-së, organeve audituese dhe institucioneve të tjera mbikëqyrëse;
- dhe, nëse gjatë shqyrtimit konstatohen indicie konkrete të shkeljeve të tjera, t'ua paraqesë dokumentacionin organeve kompetente.

Ky paralajmërim nuk paraqet presion ndaj organit shqyrtues, por njoftim të qartë se Ankuesi nuk do të pranojë që një ofertë e përgjegjshme dhe për **34,816.80 euro më e lirë** të eliminohet përmes kriterëve të papublikuara, arsyeve kundërthënëse dhe vlerësimeve pa bazë teknike.

Ankuesi kërkon vetëm zbatimin e ligjit, trajtimin e barabartë dhe mbrojtjen e buxhetit publik. Mirëpo, çdo tentim për ta ruajtur një vendim të pabazuar do të kundërshtohet me të gjitha mjetet juridike dhe institucionale të lejuara.

25. Pretendim i veçantë: Mosshqyrtimi i pretendimeve të Kërkesës së parë për Rishqyrtim

Në Kërkesën e parë për Rishqyrtim të datës **10.08.2026**, Ankuesi kishte paraqitur dy grupe të dallueshme pretendimesh:

1. pretendimet kundër përgjegjshmërisë së OE SELMANS NETWORK SH.P.K.; dhe
2. pretendimet kundër eliminimit të GOE MEB L.L.C. & CPS Phoenix Group L.L.C.

Në Vendimin e datës **11.08.2026**, AK-ja trajtoi vetëm pretendimet lidhur me gabimet financiare të SELMANS NETWORK SH.P.K., ndërsa nuk vendosi fare për pretendimet kundër eliminimit të Ankuesit.

AK-ja nuk dha përgjigje për:

- vlefshmërinë e tenderit prej 365 ditësh;
- përmbushjen funksionale të kërkesës për pajisjen;
- sqarimin e publikuar para hapjes së tenderëve;
- dokumentacionin teknik të DEMAG AC205;
- kriterin e papublikuar lidhur me emërtimin në librezë;
- trajtimin e pabarabartë të operatorëve;
- dhe kërkesën që oferta e Ankuesit të shpallej e përgjegjshme.

Ky mosveprim përbën shkelje esenciale të **nenit 108/A, paragrafëve 10 dhe 12 të LPP-së**, sepse AK-ja është e detyruar të vendosë për secilin pretendim dhe ta arsyetojë pranimin ose refuzimin e tij. Aprovimi “i pjesshëm” i kërkesës nuk e lejon AK-në të heshtë për pjesën tjetër. Çdo pretendim i patrajtuar mbetet pretendim për të cilin nuk është nxjerrë vendim i ligjshëm.

Mosdhënia e përgjigjes nuk është refuzim i arsyetuar. Është mohim i së drejtës për mjet juridik efektiv.

AK-ja më pas e ka përdorur pikërisht eliminimin e pashqyrtuar të Ankuesit si bazë për anulimin e procedurës. Pra, AK-ja ka ndërtuar vendimin e datës 25.08.2026 mbi një çështje për të cilën, në vendimin e datës 11.08.2026, kishte dështuar të vendoste.

Kjo e bën juridikisht të cenuar jo vetëm vendimin e parë, por edhe tërë rivlerësimin dhe anulimin pasues.

26. Pretendim i veçantë: Moszbatimi i masës së plotë korrigjuese pas aprovimit të Kërkesës së parë

Me Vendimin e datës 11.08.2026, AK-ja pranoi se kërkesa e Ankuesit ishte pjesërisht e bazuar dhe se vlerësimi fillestar duhej korrigjuar. Megjithatë, rivlerësimi nuk rezultoi në korrigjimin real të shkeljeve. AK-ja:

- eliminoi operatorin e rekomanduar për shkak të gabimit financiar;
- nuk rishqyrtoi ligjërisht eliminimin e Ankuesit;
- përsëriti arsyetimin e njëjtë formal;
- dhe e anuloi procedurën.

Masa korrigjuese nuk mund të jetë vetëm formale. Kur pranohet një shkelje, AK-ja duhet t'i largojë pasojat e saj

dhe ta kthejë aktivitetin në përputhje me ligjin.

Rivlerësimi që përsërit rezultatin pa i trajtuar pretendimet dhe provat nuk është rivlerësim përmbajtjesor. Ai është veprim procedural pa efekt real korrigjues.

27. Pretendim i veçantë: Kundërthënia ndërmjet vendimit të datës 11.08.2026 dhe vendimeve pasuese

Vendimmarrja e AK-së është thelbësisht kundërthënëse.

Në vendimin e datës 11.08.2026, AK-ja pranoi se pretendimi lidhur me ofertën financiare të SELMANS NETWORK SH.P.K. ishte i bazuar dhe se procedura duhej të kthehej në rivlerësim. Në vendimin e datës 25.08.2026, AK-ja konstatoi se operatori i rekomanduar nuk mund të shpallej fitues, por në vend të vlerësimit të ligjshëm të Ankuesit anuloi procedurën. Në vendimin e datës 04.09.2026, AK-ja u përpoq ta justifikonte anulimin duke përdorur arsye eliminuese për Ankuesin, të cilat nuk i kishte shqyrtuar në vendimin e parë.

Pra:

- AK-ja e pranoi shkeljen;
- nuk e korrigjoi atë plotësisht;
- nuk vendosi mbi të gjitha pretendimet;
- dhe pastaj e përdori mosvendosjen e vet për të arsyetuar anulimin.

Një organ administrativ nuk mund të nxjerrë përfitim juridik nga shkelja ose mosveprimi i vet. AK-ja nuk mund ta përdorë mungesën e analizës së vet si provë të papërgjegjshmërisë së Ankuesit.

28. Pretendim i veçantë: Mungesa e provës për një rivlerësim real

AK-ja pohon se Komisioni Vlerësues ka kryer rivlerësim, por fakti që kjo deklarohet në vendim nuk provon se rivlerësimi është kryer realisht. Kërkohej që OSHP-ja, në ushtrim të kompetencave sipas **nenit 105.2.2, 105.2.3 dhe 105.2.5 të LPP-së**, ta obligojë AK-në të dorëzojë:

- vendimin për emërimin e Komisionit Vlerësues;
- raportin fillestar të vlerësimit;
- raportin e plotë të rivlerësimit;
- procesverbalet e mbledhjeve të komisionit;
- analizën individuale të ofertës së Ankuesit;
- analizën teknike të pajisjes DEMAG AC205;
- kërkesat dhe përgjigjet për sqarime;
- arsyetimin për secilin anëtar të komisionit;
- dhe dokumentet mbi të cilat është mbështetur anulimi.

Nëse AK-ja nuk mund të paraqesë një analizë të dokumentuar, të hartuar gjatë rivlerësimit dhe para nxjerrjes së

vendimit, atëherë pretendimi se është kryer rivlerësim përmbajtjesor bie poshtë.

Dokumentet e krijuara pas paraqitjes së ankesës nuk mund të përdoren për ta plotësuar retroaktivisht arsyetimin që ka munguar në momentin e marrjes së vendimit.

29. Pretendim i veçantë: Arsyetimi nuk mund të plotësohet pas nxjerrjes së vendimit

Ligjshmëria e vendimit vlerësohet sipas fakteve, provave dhe arsyetimit që kanë ekzistuar në momentin e nxjerrjes së tij.

AK-ja nuk mund që para OSHP-së:

- të paraqesë arsye të reja eliminuese;
- të identifikojë parametra teknike që nuk janë përmendur në vendim;
- të paraqesë analiza të reja;
- ose të ndërtojë arsyetim të ri për ta shpëtuar vendimin e datës 04.09.2026.

OSHP-ja duhet ta vlerësojë vendimin sipas arsyetimit të tij të shkruar. Nëse një arsye nuk është përfshirë në vendimin e kundërshtuar, ajo nuk mund të krijohet pas ankesës. Lejimi i një praktike të tillë do t'i jepte AK-së mundësi të nxjerrë fillimisht vendime të paarsyetuara dhe t'i plotësojë ato vetëm pasi operatori ekonomik të ushtrojë mjet juridik. Kjo do ta zhvlerësonte nenin 108/A të LPP-së dhe të drejtën për mbrojtje efektive.

30. Pretendim i veçantë: Barra e provës për papërgjegjshmërinë e takon AK-së

Ankuesi ka dorëzuar dokumentacion për pajisjen, marrëveshjen e disponueshmërisë, të dhënat teknike, listën, librezën dhe fotografitë. Pas paraqitjes së këtyre dokumenteve, AK-ja nuk mund të kërkojë që Ankuesi të provojë një fakt negativ apo të hamendësojë se cilin element teknik komisioni nuk e ka konsideruar të mjaftueshëm.

Është AK-ja ajo që ka marrë vendimin eliminues. Prandaj, AK-ja duhet të provojë:

- kriterin konkret të papërmbyshur;
- faktin mbi të cilin mbështetet;
- provën teknike që e vërteton;
- ndikimin material të mospërputhjes;
- dhe pamundësinë e sqarimit.

Në mungesë të këtyre elementeve, përfundimi për papërgjegjshmërinë është supozim dhe jo konstatim ligjor.

As eksperti shqyrtues dhe as Paneli Shqyrtues nuk duhet ta marrin përsipër barrën e AK-së duke kërkuar vetë arsye të reja për eliminimin e Ankuesit.

31. Pretendim i veçantë: Shkelja e nenit 1.2 të LPP-së – integriteti, përgjegjësia dhe baza faktike e vendimit

Neni 1.2 i LPP-së kërkon që vendimet e zyrtarëve të përfshirë në prokurim dhe baza e tyre ligjore e faktike:

- të mos ndikohen nga interesa personale;
- të karakterizohen nga mosdiskriminimi;
- të kenë shkallë të lartë transparence;
- dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të ligjit.

Në këtë rast, baza faktike dhe juridike e vendimit nuk është transparente:

- nuk dihet cili parametër teknik është konstatuar i papërbushur;
- nuk dihet si është vlerësuar sqarimi para hapjes;
- nuk dihet si janë analizuar fotografitë dhe dokumentet teknike;
- nuk dihet pse 365 ditë nuk e përmbushin minimumin prej 90 ditësh;
- dhe nuk dihet mbi cilin raport konkret është marrë vendimi për anulim.

Mungesa e këtyre elementeve cenon jo vetëm rregullat teknike të vlerësimit, por edhe integritetin dhe llogaridhënien e tërë procesit.

32. Pretendim i veçantë: Shkelja e neneve 1 dhe 6 të LPP-së dhe rreziku konkret për buxhetin publik

Ligji nuk kërkon vetëm respektim formal të formularëve. Ai kërkon përdorim efikas, transparent dhe ekonomik të fondeve publike.

Anulimi i ofertës prej **174,084.00 euro**, mbi bazën e arsyeve të kundërligjshme, krijon rrezik real që Komuna:

- të paguajë çmim dukshëm më të lartë në procedurën e ardhshme;
- të përballet me shpenzime të reja administrative;
- të shkaktojë vonesa në ofrimin e shërbimeve;
- dhe të ekspozohet ndaj kërkesave për kompensim të dëmit.

Diferenca prej **34,816.80 euro** nuk është element dekorativ i ankesës. Ajo është pasojë financiare e matshme e mënyrës së gabuar të vlerësimit. OSHP-ja duhet ta shqyrtojë nëse anulimi i procedurës, në vend të rivlerësimit të ligjshëm të ofertës më të lirë, është në pajtim me **nenin 6.1 të LPP-së**. Nëse lejohet që një ofertë materialisht e rregullt të eliminohet për shkak se është e vlefshme më gjatë se minimumi dhe për shkak të emërimit administrativ të një pajisjeje që kryen funksionin e sqaruar, atëherë parimi i ekonomikitetit mbetet vetëm deklarativ.

33. Pretendim i veçantë: Anulimi sipas nenit 43.5(b) është pasojë dhe jo shkak i ligjshëm

AK-ja është përpjekur ta paraqesë anulimin si detyrim automatik, duke u thirrur në nenin 43.5(b) të Rregullores. Mirëpo, kjo dispozitë zbatohet vetëm kur, pas një vlerësimi të ligjshëm, konstatohet se asnjëri nga tenderët nuk është i përgjegjshëm.

Në rastin konkret:

- papërgjegjshmëria e SELMANS NETWORK SH.P.K. lidhet me gabimin financiar mbi kufirin e lejuar;
- ndërsa papërgjegjshmëria e Ankuesit është prodhuar përmes interpretimit të gabuar të vlefshmërisë dhe vlerësimit formalist të pajisjes.

Pra, kushti i nenit 43.5(b) nuk ekziston në mënyrë objektive. Ai është krijuar përmes eliminimit të paligjshëm të Ankuesit.

AK-ja nuk mund:

1. ta eliminojë kundërligjshëm tenderin e përgjegjshëm;
2. të krijojë vetë gjendjen sikur nuk ka tender të përgjegjshëm; dhe
3. më pas të thirret në këtë gjendje të krijuar nga vetë shkelja e saj për ta anuluar procedurën.

Ky është arsyetim rrethor dhe juridikisht i papranueshëm.

Me anulimin e arsyes së eliminimit të Ankuesit, bie automatikisht premisa faktike për anulimin e procedurës.

34. Pretendim i veçantë: Dështimi për ta zbatuar nenin 60.1.1 të LPP-së

Kriteri për dhënien e kontratës ishte tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Neni 60.1.1 i LPP-së përcakton se AK-ja ia jep kontratën operatorit që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Pas eliminimit të SELMANS NETWORK SH.P.K., AK-ja nuk kishte diskrecion të pakufizuar për ta shmangur rezultatin e procedurës. Ajo duhej:

- ta rivlerësonte ligjërisht ofertën e Ankuesit;
- t'i shqyrtonte të gjitha provat;
- të zbatonte sqarimin e vet para hapjes;
- dhe, nëse oferta ishte materialisht e përgjegjshme, ta zbatonte nenin 60.1.1.

Anulimi nuk mund të përdoret si zëvendësim për dhënien e kontratës kur kushtet ligjore për dhënie janë plotësuar.

35. Pretendim i veçantë: Cenimi i konkurrencës efektive dhe efekti dekurajues ndaj operatorëve

Mënyra e veprimit të AK-së prodhon efekt të rëndë ndaj konkurrencës.

Nëse një operator:

- dorëzon ofertën më të lirë;
- deklaron vlefshmëri më të gjatë;

- paraqet pajisje që përmbush funksionin e sqaruar;
- dhe përsëri eliminohet mbi kritere të papublikuara,

atëherë operatorët ekonomikë nuk mund të parashikojnë më se cilat rregulla do të zbatohen gjatë vlerësimit.

Kjo ul besimin në procedurën publike, dekurajon konkurrencën dhe krijon përshtypjen se kriteret mund të ndryshohen pas njohjes së ofertuesve dhe çmimeve.

Ky efekt është pikërisht ajo që nenet 1 dhe 7 të LPP-së synojnë ta parandalojnë.

36. Pretendim i veçantë: Nevoja për hetim të plotë nga OSHP-ja sipas nenit 105 të LPP-së

Sipas **nenit 105.2 të LPP-së**, OSHP-ja ka kompetencë:

- t'i shqyrtojë shkeljet e pretenduara;
- t'i hetojë dhe përcaktojë faktet;
- të kërkojë dokumente dhe informacione;
- dhe të ndërmarrë çdo masë të nevojshme për verifikimin e pretendimeve.

Prandaj kërkohet që OSHP-ja të mos kufizohet në përsëritjen e arsyetimit të AK-së, por:

1. ta sigurojë dosjen e plotë të prokurimit;
2. ta shqyrtojë raportin e rivlerësimit;
3. t'i krahasojë ofertat dhe dokumentet e pajisjeve;
4. ta verifikojë sqarimin para hapjes së tenderëve;
5. ta verifikojë dokumentin e SELMANS NETWORK SH.P.K. me datë 07.08.2026;
6. ta përcaktojë se kur është dorëzuar ai dokument;
7. ta analizojë vlefshmërinë e marrëveshjeve të pajisjeve;
8. dhe, sipas nevojës, të caktojë ekspert teknik të specializuar.

Mosadministrimi i këtyre provave do ta linte pa përgjigje çështjen kryesore: nëse AK-ja ka përdorur të njëjtin standard ndaj të dy operatorëve.

37. Kundërshtim paraprak ndaj çdo ekspertize sipërfaqësore

Ankuesi kërkon që eksperti shqyrtues ta trajtojë individualisht secilin pretendim dhe të japë përgjigje të argumentuar për secilën provë.

Nuk do të mjaftonte që eksperti:

- ta kopjojë arsyetimin e AK-së;
- të përsërisë se Dosja e Tenderit është detyruese;

- ose të deklarojë në mënyrë të përgjithshme se pajisja nuk përputhet.

Eksperti duhet të tregojë:

- cilin parametër pajisja nuk e përmbush;
- si e ka analizuar sqarimin e AK-së;
- pse 365 ditë nuk e përfshijnë periudhën 90-ditore;
- pse sqarimi i dokumenteve do të ishte ndryshim material;
- dhe si është respektuar neni 7 i LPP-së.

Çdo ekspertizë që nuk jep përgjigje për këto çështje do të jetë e paplotë, e pambështetur në prova dhe e kundërshtueshme.

38. Rezervimi i mjeteve të mëtejshme juridike

Ankuesi kërkon korrigjimin e plotë të shkeljeve brenda sistemit të shqyrtimit të prokurimit.

Megjithatë, nëse shkeljet e dokumentuara nuk korrigjohen, Ankuesi rezervon të drejtën:

- të iniciojë konflikt administrativ;
- të kërkojë kompensimin e dëmit dhe fitimit të humbur;
- të kërkojë shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimeve të zyrtarëve përgjegjës;
- ta njoftojë KRPP-në dhe institucionet audituese;
- dhe t'i përdorë të gjitha mjetet e tjera juridike të lejuara.

Ankuesi nuk do të pranojë që oferta e tij prej **174,084.00 euro** të eliminohet dhe procedura të anulohet mbi bazën e kushteve që nuk kanë qenë pjesë e Dosjes, arsyetimeve që nuk u përgjigjen provave dhe një standardi që nuk është zbatuar njësoj ndaj operatorëve.

39. Përfundim i prerë juridik

Nga të gjitha faktet rezulton se AK-ja:

- ka shpërfillur sqarimin e vet para hapjes së tenderëve;
- ka krijuar kriter të ri pas hapjes;
- ka ngatërruar emërtimin formal me aftësinë teknike;
- nuk ka vlerësuar dokumentacionin në tërësi;
- nuk ka kërkuar ose analizuar sqarimin e lejuar;
- nuk u është përgjigjur pretendimeve të para;
- ka zhvilluar rivlerësim të paprovuar si përmbajtjesor;
- ka përdorur standard të dyfishtë;

- ka prodhuar artificialisht kushtet për anulim;
- dhe ka cenuar interesin financiar të Komunës.

Këto nuk janë gabime të izoluara. Ato përbëjnë një zinxhir shkeljesh që kanë prodhuar drejtpërdrejt eliminimin e Ankuesit dhe anulimin e procedurës. Në këto rrethana, OSHP-ja nuk ka bazë të ligjshme për t'i lënë vendimet në fuqi. Ajo duhet ta aprovojë ankesën, t'i anulojë vendimet e datave 25.08.2026 dhe 04.09.2026 dhe ta kthejë lëndën në rivlerësim me urdhër të qartë për eliminimin e shkeljeve.

Nga faktet dhe provat rezulton se:

1. vlefshmëria prej 365 ditësh e përmbush dhe e tejkalon periudhën prej 90 ditësh;
2. Dosja nuk e ndalon vlefshmërinë më të gjatë dhe nuk kërkon “saktësisht 90 ditë”;
3. AK-ja ka përdorur një kriter të papublikuar, në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së;
4. pajisja DEMAG AC205 është deklaruar, identifikuar dhe vënë në dispozicion brenda ofertës;
5. AK-ja nuk ka kryer analizë të plotë teknike dhe nuk ka identifikuar parametrin konkret të përmbushur;
6. paqartësitë eventuale kanë mundur të sqarohen sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së;
7. oferta e Ankuesit është 34,816.80 euro më e ulët;
8. eliminimi i Ankuesit është i pabazuar; dhe
9. për pasojë, nuk ekziston baza faktike dhe juridike për anulimin e procedurës sipas nenit 43.5(b) të Rregullores.

PËRFUNDIM DHE KËRKESË PËR VENDOSJE

Vendimet e kundërshtuara nuk përfaqësojnë ushtrim të ligjshëm të diskrecionit administrativ. Diskrecioni i Autoritetit Kontraktues nuk është i pakufizuar dhe nuk mund të përdoret për të ndryshuar kërkesat pas hapjes së tenderëve, për të anashkaluar provat, për të vendosur kritere të papublikuara apo për të shmangur rezultatin që do të prodhonte zbatimi i drejtë i ligjit.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues:

- e ka interpretuar në mënyrë të kundërligjshme vlefshmërinë prej 365 ditësh;
- e ka shndërruar afatin minimal prej 90 ditësh në afat fiks dhe maksimal, pa bazë në Dosjen e Tenderit;
- ka shpërfillur sqarimin e vet para hapjes së ofertave se pajisja kërkohej për pastrimin e xhamave në lartësi;
- ka vlerësuar vetëm emërtimin administrativ të pajisjes dhe jo karakteristikat e saj teknike e funksionale;
- ka përdorur si kriter eliminues një emërtim që nuk ishte kërkuar në Dosjen e Tenderit;
- nuk e ka identifikuar parametrin konkret teknik që pretendohet se nuk është përmbushur;
- nuk i ka shqyrtuar në tërësi provat dhe dokumentacionin e Ankuesit;
- nuk u është përgjigjur pretendimeve të Kërkesës së parë për Rishqyrtim që lidheshin me eliminimin e Ankuesit;
- ka kryer një rivlerësim formal, pa dëshmuar analizë të re dhe përmbajtjesore;
- dhe ka përdorur eliminimin e kundërligjshëm të Ankuesit për të krijuar artificialisht kushtet për anulimin e

procedurës.

Nga të gjitha faktet, provat dhe bazat ligjore të paraqitura rezulton se oferta e GOE **MEB L.L.C. & CPS Phoenix Group L.L.C.** është materialisht e përgjegjshme, si në aspektin administrativ, ashtu edhe në aspektin teknik. Përfundimi i AK-së se “asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm” nuk është rezultat i një gjendjeje faktike objektive. Ai është rezultat i:

- interpretimit të gabuar të Dosjes së Tenderit;
- përdorimit të një kriteri të papublikuar;
- mosvlerësimit të dokumentacionit teknik;
- moszbatimit të sqarimit të publikuar para hapjes;
- dhe mosshqyrtimit të plotë të pretendimeve ankimore.

Për pasojë, nuk ekzistojnë kushtet juridike për anulimin e aktivitetit sipas **nenit 43.5(b) të Rregullores Nr. 001/2022**. Kur eliminohet nga rendi juridik konstatimi i gabuar për papërgjegjshmërinë e ofertës së Ankuesit, bie automatikisht edhe baza mbi të cilën AK-ja e ka mbështetur anulimin. Oferta e Ankuesit është në vlerë prej **174,084.00 euro**, ndërsa oferta e operatorit të eliminuar është në vlerë prej **208,900.80 euro**. Diferenca prej **34,816.80 euro** përfaqëson kursim të drejtpërdrejtë për buxhetin publik.

Eliminimi i ofertës së Ankuesit dhe anulimi i aktivitetit, mbi bazën e arsyeve të pambështetura në ligj dhe në prova, cenojnë:

- qëllimin e LPP-së;
- përdorimin ekonomik dhe efikas të fondeve publike;
- trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin;
- transparencën;
- konkurrencën efektive;
- proporcionalitetin;
- sigurinë juridike;
- dhe të drejtën e operatorit ekonomik për mbrojtje efektive.

Këto shkelje nuk janë formale dhe as të parëndësishme. Ato kanë ndikuar drejtpërdrejt dhe në mënyrë vendimtare në rezultatin e aktivitetit dhe i kanë shkaktuar Ankuesit dëm material, shpenzime procedurale dhe humbjen reale të mundësisë për fitimin e kontratës. Në këto rrethana, lënia në fuqi e vendimeve të kundërshtuara do të legjitimonte një precedent të papranueshëm: që një autoritet kontraktues ta ndryshojë kuptimin e kërkesave pas hapjes së ofertave, të mos u përgjigjet pretendimeve, ta eliminojë tenderin me çmimin më të ulët dhe ta anulojë procedurën sapo operatori i rekomanduar fillimisht rezulton i papërgjegjshëm.

Një rezultat i tillë do të ishte në kundërshtim të hapur me nenet 1, 6, 7, 28, 52, 56, 59, 60, 69, 72, 105 dhe 108/A të LPP-së, me Rregulloren Nr. 001/2022 dhe me parimet themelore të prokurimit publik.

PROPOZIMI PËR VENDIM;

Duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Rregulloren Nr. 001/2022, dokumentet e procedurës dhe provat e bashkëngjitura, i propozojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-së që të nxjerrë këtë:

VENDIM

I. APROVOHET, si plotësisht e bazuar, ankesa e **GOE MEB L.L.C. & CPS Phoenix Group L.L.C.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër **642-26-4703-2-1-1**.

II. ANULOHET DHE SHFUQIZOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Mitrovicës Jugore, i datës **25.08.2026**, për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

III. ANULOHET DHE SHFUQIZOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues, i datës **04.09.2026**, me të cilin është refuzuar Kërkesa e dytë për Rishqyrtim e GOE Ankues.

IV. KONSTATOHET se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 7, 56.3, 59 dhe 108/A të LPP-së, duke:

- mosshqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore;
- përdorur kriter të papublikuar;
- mosvlerësuar në tërësi dokumentacionin teknik;
- mosdhënë arsyetim konkret për papërgjegjshmërinë e ofertës;
- dhe moszbatuar standard të barabartë ndaj operatorëve ekonomikë.

V. KONSTATOHET se vlefshmëria e tenderit prej **365 ditësh** e përmbush dhe e tejkalon periudhën minimale prej 90 ditësh të përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe se ajo nuk përbën devijim material apo shkak ligjor për eliminim.

VI. KONSTATOHET se Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë prova dhe arsyetim të mjaftueshëm teknik për përfundimin se pajisja **DEMAG AC205** nuk e realizon funksionin e kërkuar për pastrimin e xhamave dhe sipërfaqeve në lartësi.

VII. KONSTATOHET se AK-ja ka qenë e detyruar ta marrë parasysh sqarimin e publikuar para hapjes së tenderëve, sipas të cilit qëllimi i kërkesës për pajisjen ishte pastrimi i xhamave në lartësi, dhe nuk ka pasur të drejtë që pas hapjes ta shndërronte emërtimin në librezë në kriter të veçantë eliminues.

VIII. KONSTATOHET se nuk është plotësuar kushti faktik dhe juridik për anulimin e aktivitetit sipas nenit 43.5(b) të Rregullores Nr. 001/2022, sepse oferta e Ankuesit nuk është provuar ligjërisht si e papërgjegjshme.

IX. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues që aktivitetin e prokurimit ta kthejë në rivlerësim të plotë, objektiv dhe të ligjshëm, duke:

1. i eliminuar nga vlerësimi kriteret e papublikuara;
2. e trajtuar vlefshmërinë prej 365 ditësh si përmbushje të periudhës minimale prej 90 ditësh;
3. e vlerësuar pajisjen e Ankuesit sipas dokumentacionit teknik, funksionit real dhe sqarimit të publikuar;
4. i trajtuar operatorët ekonomikë sipas të njëjtit standard;
5. dhe e zbatuar kriterin “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”, sipas nenit 60.1.1 të LPP-së.

X. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues që, pas korrigjimit të shkeljeve dhe konstatimit të përgjegjshmërisë së ofertës, të vazhdojë me rekomandimin për dhënie të kontratës **GOE MEB L.L.C. & CPS Phoenix Group L.L.C.**, me çmim të ofertuar prej **174,084.00 euro**.

XI. URDHËROHET AK-ja që t’ia dorëzojë OSHP-së dokumentacionin e plotë të procedurës, përfshirë:

- raportin fillestar të vlerësimit;
- raportin e rivlerësimit;
- procesverbalet e Komisionit Vlerësues;
- kërkesat dhe përgjigjet për sqarime;
- analizën teknike të pajisjeve;
- dokumentacionin e pajisjes së SELMANS NETWORK SH.P.K.;
- dokumentin me datë 07.08.2026 dhe të dhënat për kohën e dorëzimit të tij;
- si dhe çdo dokument mbi të cilin është mbështetur anulimi.

XIII. OBLIGOHET AK-ja që t’i zbatojë urdhrat e OSHP-së brenda afatit të përcaktuar dhe ta njoftojë OSHP-në dhe palët për veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Me respekt,

MEB L.L.C. & CPS Phoenix Group L.L.C.

Vendi: Prizren

Data: 14.09.2026